

85H-32

€ 85

LLAZAR CUÇI

# TOKE DHE QIELL

novelë

891.P83-32

985

LLAZAR ÇUÇI

# TOKË DHE QIELL

novelë

671

BIJOTEKA E SHITETIA  
SHKOLLORË

~~5-2303~~

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

# I

Tutje, deri në buzë të detit, shtrihen ato toka të pasura në bereqet, ku shpërthejnë bimë të ndryshme, lloj-lloj pemësh dhe ku rriten bagëti e shpezë me bollëk.

Dimri atje është i butë dhe shpesh fryjnë erëra të ngrohta. Në verë drita e diellit është e fortë, prandaj, me sa duket, bujqit i kanë bishtat e syve të rrudhosur dhe lëkurën të zeshkët. Edhe gjelbërimi është i pashterur në ato toka, ashtu si drita e diellit. Pranvera vjen e hershme. Vera është e gjatë dhe e freskët nga puhia e lagët që sjell era e detit. Shirat e para të vjeshtës ringjallin një pranverë me ngjyrë të çuditshme.

Dy kufi të mëdhenj natyrorë e rrethojnë atë vend. Kufi të palëvizshëm, siç thonë fshatarët që as i largon e as i afron dot. Deti pa anë e fund nga perëndimi, dhe një fushë e gjerë dhe e gjatë sa s'ta zë syri nga lindja. Kjo fushë mbaron me një brez kodrash, të cilat mezi shquajnë në vijën e horizontit. Toka e saj është e shkretë se atje nuk mbin asgjë. Prej së largu, ajo duket e përhi-me dhe e sheshtë, si fundi i një tepsie të bakërtë.



Ujët e mbulon gjithë dimrin dhe pastaj, në verë, largohet duke lënë aty një shtresë kripe, që e shterpëron së tepërmi. Avujt e nxehtë, që ngrihen lart, formojnë rreth e përçark reflekse uji, si ata liqejtë e gënjeshtërt në shkretëtirë. Dhe, kur që nga xhadeja zbret ndonjë kamion që çan përmes, nëpër tragat, duke lëshuar një bisht pluhuri, ai merr forma të çrregullta fantastike dhe ngjason me një përbindsh, që shkarrëzitet me duf. Atëhere, lejlekët e plogët bashkojnë shalët e thata, si paterica, dhe fluturojnë me përtesë, si malarikë, gjer te arat pranë pyllit me pishë të moçme.

Në anë të pyllit, ndërmjet fushës së shkretëtë dhe detit të kaltër, shtrihen shtëpitë e fshatit, me rrugë e rrugica të drejta. Shtëpia e kulturës, përmendorja me pllakë mermeri, kryesia dhe dyqanet e kooperativës të kujtojnë një qendër qyteti të vogël. Përmendorja ka një yll të kuq në majë dhe në pllakë janë skalitur emrat e dëshmorëve të fshatit.

Edhe më parë fshati kështu ka qënë, i mbledhur grumbull. Por kasolleve të atëhershme, që mbështeteshin brinjë më brinjë, nuk u ka mbetur as nam e as nishan. Me sa duket, bujqit ndjenin nevojën e njëri-tjetrit në çdo çast, ngaqë ishin në një vend kaq të largët e të mënjanuar. Vetëm një muhaxhir, siç i thoshin, që kish ardhur e kishte zënë vend në ato anë, ndërtoi një shtëpi të mënjanuar dhe i ktheu kurrizin fshatit. Ai e leu shtëpinë edhe me bojë të verdhë dhe ajo shquante prej së largu. Edhe sot ajo qëndron ca e mënjanuar dhe me gjurmët e kohërave përmbi çati.



Kur erdhën thirrjet e ushtrisë për djemtë e kurasë, arat, aty buzë pyllit me pishë, ishin kthyer në ugare. Pylli kishte nisur të shushërinte më dendur nën erërat e vjeshtës dhe deti, pak më tutje, dërgonte që andej zhaurimën e ujit të dallgëzuar.

Njerëzit, që në mëngjes, ishin mbledhur atje te qendra. Këndonin e kërcenin. Pak më tutje qëndronte kamioni i kooperativës, i mbuluar me mushama dhe me parulla të kuqe në ballë dhe në të dy spondet. Nga drejtime të ndryshme vazhdonin të vinin njerëzit grumbuj-grumbuj për në qendër. Ata ecnin me nge.

— Kur u nis yt atë partizan, i dhashë me vete çorape të leshta, triko dhe dorashka leshi; i bëra dhe një kulaç me vezë dhe i mbështolla një grusht fasule në shami. Dhe më ngjante sikur tërë kohën, atje në mal, me ato që i dhashë unë e mbajti shpirtin. Ty çorape s'të duhen, triko jo, vetëm kulaçi e djathi, dhe vetëm për një ditë. Babanë tënd s'e gjeja dot as me letra, as me njeri. Ai, ku ngrysej, nuk gdhijej. Në të rrallë na vinte nonjë haber. Ty të nisim sot dhe pas një jave marrim letër nga ushtria...

Vetëm nëna kuvëndonte dhe dukej sikur nuk fliste me fëmijët e saj, por me dikë tjetër, me atë që kish përcjellë njëzet e ca vjet të shkuara, kur Todi s'e kishte parë dritën. Ajo sillte në mend ndarjen nga i shoqi, fshehurazi, një natë ndanë fshatit.

«Mjaft — i kishte thënë ai, — Ktheu një-mendi se u err dhe s'duket rruga».

Nga ana e detit, andej nga perëndimi, vinte zbardhëllimi, që binte mbi rrëketë e pellgjet dhe ngrinte reflekse të shpëlara në mugëtirë.

Dy siluetat e tyre të errëta çapiteshin le-  
dhit. Ato herë ngjiteshin më lart se vija e hori-  
zontit, herë vareshin poshtë dhe shkriheshin me  
tokën. Kur ngriheshin mbi horizont, atij i shqu-  
ante në kurriz një torbë e fryrë, ndërsa në tru-  
pin e saj të hollë përvijëzohej një bark i madh,  
i rënduar. Rëndësia e barkut e mundonte dhe e  
bënte të ngathët, saqë vende-vende, ku ledhi vinte  
i përpjetë, ajo kapej pas dorës së tij që i nderej  
dhe mezi çapitej prapa të shoqit.

«Mjaft de, ktheu! Dhe ki mendjen mos rrësh-  
qet në këtë djallo ledh...»

«Ç'më duhet ledhi mua?...»

«E, ashtu, çaj më mirë përmes».

Të dy hijet qëndruan ballë për ballë. Ai lëvizi  
torbën mbi kurriz dhe zgjati kokën drejt asaj.  
Ajo mbështolli krahët në gjoks dhe mbështeti ko-  
kën e varur në duar. Flokët iu derdhën dhe nisën  
t'i lëkundeshin nga era. Shamia i kish rrëshqitur  
prapa qafës.

«Hajt, mirë mbetsh, mëmë! Bëj durim, bëj si  
të bësh... edhe pakëz na mbetet...»

Dy hijet u bashkuan kokë më kokë. Ndenjën  
ca ashtu. Pastaj burri u kthye e iku me hap të  
rëndë e të madh. Gruaja nisi të qante me ngashë-  
rim të mbytur, duke fshirë lotët me cepat e sha-  
misë së kokës. Trupi i saj i hollë herë epej mbi  
barkun e rënduar, herë drejtohej së tepërmi dhe  
koka i binte pas.



Era u platit dhe shiu, sikur të qe fshehur aty buzë pyllit me pishë, ja dha më tërsëllëm.

«I bekuari shi! Nuk lë një pikë mangut. Sikur s'e sheh që fusha u mbufat, që u mbyt dynjaja. Mos është ky viti i kiametit? Mos vallë i erdhi fundi kësaj jallaneje? — Hej, millet! Po dalin të vërteta fjalët e shën Pjetrit, po mos harroni edhe porositë e tij... Mos harroni të varni në derë torbën me misër. Lumë ai që do shpëtojë nga kjo kataklizëm! Me lugë floriri ka për të ngrënë...» Këto tha me vete gruaja, që mbeti vetëm e mbështjellë nga shiu dhe errësira.

Një gjarpër i zjarrtë u shkëput nga retë drejt zemrës së dheut dhe toka e përpiu, se toka i përpin gjarpërinjtë sido që të jenë. Shpërtheu një bubullimë krismëm madhe, që u duk se çau qiellin më dysh. Por qielli është i pafund dhe i përpin bubullimat krismëmëdha dhe, kur hap dita e re, atë e pastron era e malit, që, pas stuhisë, e bën më të kaltër se ç'ka qenë.

Tokë e lashtë kjo fushë që shtrihet në prehër të maleve të ashpër. Kjo fushë asnjëherë nuk ka ngurruar t'u mbushë barkun maleve të uritura, t'u japë lëkurë bualli për opinga dhe ndonjëherë t'u plotësojë edhe tekat prej burrash të qëmoçëm... «Balta ka bereqet» thoshin bujqit.

Pas bubullimës, gruaja ish përmendur dhe ish çapitur me nxitim, përmes udhës së lerosur e tërë traga nga qerret. Në sytë e saj të qullur nga lotët lëkundeshin njollat e atyre dritave të rralla të fshatit. Në gojë mbante e shtrëngonte me dhëmbë cepat e shamisë dhe ndjente kripësirën e lotëve, si shëllirë.



Në errësirë u ndie kërkëllima e një qerreje, që mezi çante baltën me rrotat e saj të shtrembra. Rrotat zhurmonin mbyturazi. Shiu binte mbi rrogozin e mykur, kthyer si kube dhe rridhte anëve. Brenda ndizej e shuhej një cigare.

— Oaha! — u thirri xha Uani qeve të qerres — më këtej, të uruar! Hidhini të tharat se u errëm nëpër baltëra.

Uan Kërri, duke kërkuar në errësirë, shqoi një hije gruaje, që ecte përmes baltës. E kredhur gjer në gju, ajo ngjante sikur kishte dalë nga balta dhe rrëshqiste mbi të, drejt fshatit.

Uani krojti fytyrën e ngjirur.

— Ë, ëëë. Dale, moj ti, e handakosur!... nga u fanepse para qerres time, në këtë rrebesh?...

Ajo e përmbloodhi veten njëherësh. Fshiu fytyrën me pëllëmbët e lagura dhe ndjeu freski.

— Aman, xha Uan! Se mos, Xhezua...

— Të paskan lënë mendtë ty, moj. Je në të ti, apo jo? Yt shoq e nxjerr atë kafshitë koromane në qytet. Andej, se nga rropatet, e ndihmofte zoti... Ku dimë ne...

— E, ashtu, xhanëm...

— Tamëm kështu është, moj. Yt shoq tërë monë i larguar ka qenë?... Po ti hip këtu në qerre se të ka hyrë ujët në palcë.

Këto fjalë të Uan Kërrit e lehtësuan gruan. Ajo nisi të mendonte për fëmijët dhe shtëpinë. Mendja i brodhi edhe pas të shoqit, por prapë iu kthye në vend, kur ajo ndjeu në barkun e rënduar një fërfëllimë dhe një goditje në ijen e djathtë.

Si u struk në një cep të qerres, solli nëpër mend hallet e shtëpisë. Ajo kishte nja dy karroqe

miell të grynjtë dhe nja dy qase misër të pabluar. Fëmijët do ta kalonin edhe atë dimër me ato veshje e mbathje që kishin. Për këtë s'donte t'ja dinte se do t'i kuturiste ca tufa liri e do të endte ca pëlhurë për ta, sa të mos mbeteshin barkjashtë. Vetëm për të mbajtur shpirtin me bukë, duhej vrrarë mendja.

Ajo ishte argasur me hallet e shtëpisë, se i shoqi robohej në molon e qytetit andej tutje, për të nxjerrë bukën e fëmijëve. Kur vinte ai me ndonjë thes grurë e misër, i dukej se qe kthyer nga kurbeti dhe nuk e mërziste. I mbante përbrenda të tëra ç'kish hequr dhe i bëhej qejfi, tek shikonte që ai gëzohej me fëmijët. Dontë që ata të mos e kuptonin vrrerin e atyre kohërave. Se nuk qe i pakët edhe vrreri i malarjes që i digjte përbrenda.

«Varfëria mërzitje e grindje sjell. Po ç'të mirë sjell mërzitja e grindja?» Mendonte dhe heshte. Gëzohej kur shikonte të shoqin në qoshe të konakut, mbushur prehërin me fëmijë. Ai i përkëdhelte. Ata i puthnin mjekrën e parruar dhe shëmtoheshin e qeshnin. Kishte nevojë edhe ajo vetë për këto çaste dhe priste të kënaqeshin të vegjëlit, që pastaj t'i ushqente, t'i vinte në gjumë dhe, më në fund, t'i afrohej edhe vetë prehrit të tij... Mbështilleshin me një fije velenxe pa ngjyrë e të strepur, në qoshen tjetër të konakut, dhe aty ajo kujtohej e vinte në vete se ishte një grua me burrë.

Kështu bëri edhe atë natë, para se ta përcillte, atje buzë gjolit. Atë natë, ai i kishte thënë:



«Më vjen keq, që po të lë këtë në bark...»

«Mos e thuaj atë fjalë. Si ta nxë goja! Këta fëmijë janë kismetit ynë!..»

«Të kam rënduar shumë».

«Mos u sëkëlldis për ne. Në mes të njerëzve jemi.»

«Ki mendjen se ka edhe ujë... Ujëtit janë tromaksur maleve dhe kanë zbritur fushës...»

Ai iku për t'u bashkuar me çetën e Malla-kastrës. Gjithë kohën, para syve i dilte barku i saj i rrumbullakët e i rënduar dhe i dukej se prapa kishte lënë një botë të tërë, që së shpejti do të shpërthente. Dhe ai po shkonte maleve, që, së andejmi, nëpërmes tytës së pushkës, t'i dërgonte asaj bote ajrin dhe dritën, që kish nisur të shkrepse majave.

Todi, për të ruajtur këmbët nga pluhuri, ecte buzë kanalit, nëpër ledh. Pas tij vinte e motra, Gora. Ndërsa nëna çapitej pa teklif në mesin e rrugës. Pluhuri i ngjitej pas fustanit të zi e të gjatë. Ajo po arrinte të pesëdhjetat, por dukej më e plakur se ç'ishte në moshë, më e rraskapitur. Kishte bërë një jetë të rëndë, plot brenga e halle. Kur i shoqi doli partizan, i la mbi shpatulla një barrë të madhe. I la tre fëmijë, që dinin të thoshin vetëm «bukë», dhe barkun të rënduar... Dhe i tha:

«Bëj si të bësh. Ditët janë të numëruara. Nuk do të zgjasë shumë. Shiko fëmijët dhe veten, dhe mos u merakos për mua...»

Dhe ajo bëri si bëri dhe rriti një nga të katër... rriti Gorën. Tre të tjerët ja rrëmbeu



malarja. Ja mbuloi zjarrllëku ditë me radhë, gjer-  
sa u tretën si qiri para syve të saj e u bënë për  
lumë! Rriti një nga të katër fëmijët e luftës.  
Aty nga fundi i vitit dyzet e gjashtë lindi **djalë. Ja,**  
djali u bë burrë e po shkon ushtar. U bë zot i  
vetes. I ati njohu vetëm hapat e tij të para dhe  
s'pati fatin ta shihte. Eh, sikur të ish gjallë e ta  
shikonte tek po nisej ushtar.

Gora, që vinte pas tij, megjithëqë ishte një  
vit më e madhe në moshë, vinte më e pakët në  
trup dhe e imët në fytyrë. Ai kishte hedhur aq  
shtat saqë në moshatarët nuk ja gjeje shokun. E  
ëma thoshte se ishte tërë si i ati, në daç nga  
të folurit e në daç nga pamja.

«More, po s'i ka lënë gjë t'et... Po edhe  
hijen e së ëmës e ruan, ama...» Thoshin fshata-  
rët. Dhe të tërëve u bëhej qejfi.

Edhe Uan Kërrit i bëhej qejfi. Ndoshta edhe  
më tepër se të tjerëve. Por ai drithërohej kur  
shikonte Todin dhe i therte në zemër; drithë-  
rohej se kujtonte të anë që e kish lënë këmba-  
doras dhe i pikte në zemër se i shëmbëllente me  
djemtë e tij, që do t'i kishte burra që të tre. Ush-  
trinë do ta kishin mbaruar qëkur, se qenë më të  
mëdhenj se Todi. Do të ishin bujq të mirë, se  
Uan Kërri vetë do t'i mësonte, edhe fusha me  
dheun, afshin dhe vlagën e saj do t'i bënte për  
vete. Do bëheshin ndofta traktoristë apo kombaj-  
nerë, po prapë tokës dhe bereqetit nuk do t'u  
ndaheshin.

Toka tërë monë e ka lidhur pas vetes myze-  
qarin. Era e dheut, që ngrihet pas parmendës, për  
të ka qenë dhe mbetet afshi jetëdhënës, aro-

ma më dehëse. Edhe atëhere, kur mbi kurriz i rëndonte jeta e zyrtë, që i mbështillej si ajo pezhishka e merimangave nëpër kashtën e kënetës, Myzeqari nuk iu nda tokës. Zvarrë është hequr, kockë e lëkurë, pas parmëndës, por dheu i murmë ja ngrohte kockat. Dhe ai nxirrte zëra të mekur:

«Ohaa, oha në vijë! Uhaa, plaç!...»

Sot djemtë mund të bëheshin ç'të donin, po vetëm të ishin! Se Uan Kërri do t'ua bënte hallall. S'kishin ç'të bëheshin tjetër veçse njerëz të ndershëm e punëtorë të regjur e të ngjizur në baltën e Myzeqesë. Mirëpo ajo mina ogurzezë, që një mëngjez u gjend te praku i Uanit, ja rrëmbeu që të tre sikur të mos qenë. Fluturuan e u bënë pluhur që të tre dorë për dorë, ashtu siç kishin hipur përmbi atë përbindsh, që ishte zvarritur nga anë e anës gjer në këtë breg të detit.

— S'më ha mortja mua!... — thoshte Uan Kërri.

Dhe ja, xha Uani rronte. Atë ditë kishte dalë te sheshi i fshatit. Ai po përcillte djemtë e kurasë. Po përcillte Todin. Dhe aty, në anë të sheshit, ulur në një kërcu marine, kujtonte vjetët e shkuara. Solli në mend atë natë vjeshte me shi e tufan, kur i ati i Todit u nis për t'u bashkuar me çetat. Uan Kërri nergut kishte dalë me qerren ndanë fshatit, që të përgjonte ndonjë të lig, siç qe Xhezua, ai muhaxhiri, që zuri vend në fshat dhe ndërtoi një shtëpi të verdhë. Që atë natë, ai vendosi që të kujdesej edhe për familjen, që mbeti pa burrë në shtëpi.

«Burri është trari i shtëpisë», thoshte ai. «Dhe



atë të shkretë koromane mos ua fshih kurrë fëmijëve. Sapo e nxjerr nga çerepi, vëre mbi pezul. Ta shohin e t'u ngopet syri varfanjakëve. Se syri e nginj barkun...»

Pastaj erdhën kohë edhe më të rënda. Kokrrën e misrit nuk e gjeje dot, pale doktor e ilaçe për malarjen, që kish nisur të bënte kërدينë. Ishin hapur fjalë se matanë gjolit, në qytetin buzë detit, banonte një doktor mirëbërës. Po ku ja dilje dot të merrje një rrugë aq të gjatë, dhe me se? Me një qerre, që sa nuk zbërthehej në mes të rrugës, e me dy buaj, që mënd plaseshin të ngordhur përdhe.

Mbaroi edhe lufta. Burrat, që mbetën gjall, u kthyen në shtëpi. Nisën punën. Mirëpo armiqtë qenkeshin të vrazhdë e të pabesë. Le që ku e gjetën besën ata. Në një natë të shqetësuar dimri ata i rrëmbyen edhe katër bij të fshatit. Në mes të tyre edhe babanë e Todit. U shtuan edhe katër emra në pllakën e lapidarit.

— S'mjaftuan djemtë që mori lufta; u dashkan të tjerë... — thoshin fshatarët.

— Prapë jetimë të tjerë.

Kur Todi mbushi të shtatat, Uan Kërri i tha së ëmës.

— Dëgjomë mua, Uanin trutharë: mos e mba të mbyllur djalin, mos e ruaj si në kuvli. Në daç në qelq fute, e liga po të jetë nisur... Lëshoje fushës të harbojë. Fusha e rrit e i forcon këta. S'është më ajo fusha e parë me malarje në çdo pëllëmbë, jo. E ke parë se ç'po bëjnë me atë kaçatorin? Ai vjen vërdallë mbi gjol dhe lëshon helm në fole të konupeve. Lëre çunin, dëgjomë mua...



Edhe e ëma e shikonte se duhej lënë djali më i lirë. Ajo e kuptonte këtë si dhe nevojën e punës. Po ja që nuk e bënte dot. Ishte lidhur së tepërmi pas tij. Mirëpo të tjerët s'ja donin të keqen.

— Tamëm, tamëm, xha Uan... Ashtu është, atë po mendoj... Po ja...

Dhe Todin e lëshuan fushës me pata e biba. Tërë pasditen, gjersa errej, e kalonte andej, buzë gjolit, me librat e shkollës në çantën prej liri. Gjoli i dukej i paanë dhe i pakapërcyeshëm. Përtej nuk dallonte gjë tjetër veçse majat e largëta të maleve.

Todi kishte dëgjuar se andej kishte rrugë, maqina dhe qytete. Ai përfytyronte një botë tjetër, të çuditshme për të.

Në fillim ishte i vetëm në mes të asaj fushe të gjerë e të gjatë. Vetëm bibat e patat kishte pranë dhe mërzitej. Mezi e priste perëndimin e diellit, që të kthehej në fshat. Këtë ja tha edhe së ëmës dhe ajo zuri ta merrte me vete për të shkullur grëmin nëpër ugare ose për të pastruar vijat e ujit, ose për të hapur plehun; kur lodhej, i tregonte ndonjë shtroerë dhe e linte atje.

Pastaj u rrit çupa e Uan Kërrit, Lira, dhe atëhere ai nisi të shkonte më i gëzuar me pata, bashkë me të.

Lira ishte nja dy vjet më e vogël dhe domosdo, si çupë që ishte, nuk kishte kërkesat e tij, prej çuni! Por dhe ajo kish nisur të mendonte për qytetet, rrugët, maqinat... Nganjëherë edhe grindeshin me fjalët: jo ka, jo s'ka... jo bëhet, jo s'bëhet... Por, sido që të ishte, u mësuan që të dy dhe shkonin përditë me pata, bridhnin fushës e luanin dokraz me çomagë marine.

Dhe kështu, para syve të Uan Kërrit, u rrit

Todi dhe pas tij edhe çupa e tij e fundit Lira. Që të dy punonin në një brigadë. Më pas ajo shkoi në kurs, mësoi maqinën, u bë shofere, mbathi pantallona doku dhe vuri një kasketë burrash mbi leshrat e verdhë si kashtë gruri. Kokorithkat e verdha, që i binin mbi ball, i jepnin hije çapkëni.

Uan Kërri kishte edhe dy çupa të tjera. Ato ngjanin më tepër si mbesat e tij, se që mplakur e kish rënë shumë.

Në fillim bujqit mendonin me keqardhje dhe i thoshin:

— Ç'tu deshën këto çupa në pleqëri, o Uan Kërri? Këto ta shkurtuan ymrin fare, o i zi...

— Hee, ç'të bësh! Nuk e gradova mirë, të shkretën... Desha djem, se djemtë m'i rrëmbeu miinaaa...

— Po jo tre, or i uruar...

— E, po mendje është e shkreta dhe lajthitet...

Por çupat rriteshin. Dhe dalëngadalë edhe bujqit filluan të mendonin ndryshe për to dhe për gjithë çupërinë e fshatit.

E kanë pasur zakon në ato anë që në fushë dilnin të tërë: burra, gra, çupa e djem. I bënin shërbim tokës me ç'të mundnin, por më shumë me krahë, me duar e thonj. E çanin me parmendë, e lessonin me lesë druri, e thërmonin dhe s'ja ndanin syrin dheut që t'i zhvatnin së paku një karroqe bereqet më tepër dhe t'i ngopej syri beut e të linte ca për ata!...

Gratë dergjeshin nëpër ara edhe me bar-kun te buza. Kurse çupat e vluara, gjersa u pritej dita, hem punonin në arë, hem thurnin



të brendshmet e linjta. Për atë pajë të varfër, që do t'i çonin burrit, mendonin arave, mendonin edhe nën velenxë.

Në ato anë, nuk nxitonin për martesën e çupave, se i kishin krahë në shtëpi.

Aty, nëpër rrugët, në arë e kudo, kryqëzohen tragat e qerreve me gjurmët dhëmb-dhëmbë të traktorit, gjurmët e grave me ato të burrave. Vetëm se, ku i nxjerrin çupat nga dera, u dhëmb zemra.

Uan Kërrit do t'i dhimbe zemra dyfish se ai nuk do të fuste nuse në shtëpi... Ai vetëm do nxirrte, do nxirrte, do nxirrte...

Prandaj, atë ditë, atje te sheshi i fshatit, Uan Kërrit, i pikte në zemër, kur shikonte Todin në mes të djemurisë. Dhe kujtonte të kaluarën një për një... Kujtonte të kaluarën e tij, që ngjante si një tragë e shtrembër, që humbiste në errësira të thella dhe sillte në mend atë pak jetë të Todit. Nuk mund t'i ndante këto se qenë të lidhura, qenë një vazhdimësi e jetës së fshatit.

Ai rrinte mënjanë, ulur në një kërcu marine dhe tymoste duhanin e tij vjeshtuk.

— Tungjatjeta, xha Uan, — e përshëndeti së largu Isai i Xhezos.

«Po ky verdhacuk nga m'u faneps këtu? I shkrepin syzat si sytë e maçokut... Le që ka dalë, po seç kërkoka... qenka ca i merakosur djalli i verdhë...»

— Ç'ke që mërzitësh, Xha Uan?

«Mërzitem!... Djalli i verdhë!...» — Gëzohem, or çuni i Xhezos... «Po ashtu të tregojnë syzet» — desh të shtonte Uani.



— Já edhe unë të gëzohem kam dalë...

«Të njoh, të njoh»... deshi të thoshte plaku. Tundi kokën dhe heshti.

Kur iu afruan ca të rinj dhe iu lutën të çohej me ta, ai foli urtë-urtë:

— Më lini edhe ca, aman, se më bloi qo e shkretë rrumatizëm. Të më taraksin një çikë gju-njët, pa dhe valle do hedh sot.

Lira këndonte e kërcente me të rinjtë dhe më të rrallë shkante tek i ati dhe e përqafonte.

— Ata s'po duken, — i thosh dhe, pasi rrinte një copë herë aty, shkante te kamioni i mbuluar me mushama. Ajo kishte dy vjet që punonte me maqinën e kooperativës. Çonte gjer në qytet prodhime dhe merrte që andej të tjera. Kishte bërë edhe rrugë më të gjata, bile gjer në Tiranë. Pa le pastaj nëpër fushat e kooperativës s'kish lënë pëllëmbë dheu pa shkelur. Por gëzim si i sotmi nuk pati provuar ndonjëherë. Në ballë të kamionit të larë e të pastruar dhe në të dy spondet kishte ngjitur parulla të shkruara me beze të kuqe. Në njërën nga ato ishte shkruar: «Të mësojmë nga fryma revolucionare e ushtrisë».

Edhe Lira vetë pat shkruar në një letër vizatimi: «Djemtë tanë, ushtarët tanë!» Dhe e kishte ngjitur në xham të kabinës.

Uan Kërri gëzohej si çilimi tek e shikonte çupën atje pranë kamionit. Dhe përsëri mendja i gjezdiste në ata vjet, që kishin mbetur prapa kurrizit. Qerrja e tij me të dy buajt, që mënd plaseshin përdhe nga dobësia, i dilte para syve tek travatiste nëpër udhët e lerosura të fshatit. Edhe kërkëllitjet e bucelave të thara ja çonin Uanit

mendjen gjer larg, në ato kohëra, kur ai donte një ditë të tërë për të bluar një qase misër.

Mendimet e xha Uanit, që kapërcenin e fute-shin në thellësitat e më tepër se gjysmë shekulli prapa kurrizit, s'kishin të sosur atë ditë. Vetëm kur dha ballë nëna me Todin e Gorën te sheshi, ai u vuri fre atyre.

Nëna ecte pak përpara dhe gjithmonë i hidhte këmbët pa teklif. Megjithëqë po arrinte të pesëdhjetat dhe ngjante shumë e plakur, ajo e mbante trupin drejt dhe ballin tërë rrudha lart. Vinte e hollë dhe fustani i zi gjer te këmbët e tregonte më të gjatë se ç'ishte. Në kokë mbante një sharp të zi, që shquante shumë përmbi flokët e thinjur, të bardhë si dele.

«...Unë e Gora mbetemi në shtëpi; e, po ç'ka. Unë jam e fortë, mbahem edhe ca, edhe çupën e kam krah. Ç'ka se do jemi vetëm në shtëpi: egërsirat e pyllit nuk zbresin më në fshat se i ka trembur traktori. Ne jemi në mes të fshatit... S'jemi si shtëpia e verdhë...» Mendonte nëna dhe çante udhën përpara.

— Po hajde, moj e uruar, de, hajde! Se na thave synë, se na le të thartohemi në mendime.

Nëna qeshi me gojën mbyllur, siç e kish zakon, dhe rregulloi sharpin mbi kokë.

Mesdita po afronte. Arat po binin nën hijen e pyllit. Përnjëherësh sikur të qe fshehur aty nëpër gjerdhe, doli era. Frynte erë nga deti. Më të mëngjër të pyllit, andej nga mbaronin pishat e errëta, shpërthenin reflekset verbonjëse të detit, që kish nisur të dallgëzonte.

Një grup njerëzish kishte zënë vend në anë



të sheshit, karshi pllakës së mermertë. Uan Kërri rrudhte sytë, për të shikuar më mirë në atë drejtim. Që andej, ndanë grumbullit të njerëzve, ai pa Todin me Lirën, që qëndronin pranë e pranë dhe dukeshin të menduar. Ata flisnin për diçka me rëndësi. Po përse? Këtë Uani s'e merrte dot me mend. Mund t'i shkonte mendja kudo, po jo për atë, që po flisnin të rinjtë.

«Sa mirë! — tha me vete. — Eh, sikur të bëhet!.. E pse, xhanëm, të mos bëhet?»

Dhe prapë zuri ta hante meraku se nuk do dëgjohej asnjë e qarë fëmije në shtëpinë e tij. Kjo e bënte të vriste mendjen për martesën e çupave të tjera. Afërmendsh, kjo i takonte së voglës, asaj të pleqërisë. Me atë duhej ta lidhte jetën. Po sikur çupave t'u dilte fati në qytet? Jo, Uani s'do ndahesh kurrën e kurrës nga fshati. Ai ishte i lidhur me tokën. Po edhe çupat s'do ta linin kurrë këtë... .

«Hej, bela! — mendoj, — ç'më mbytën këto mendime kështu. Tutje, lanet qofshin! Çdo gjë ka radhën e saj...»

Isai u faneps prapë aty. Gjezdiste si hije verdhacuke me syze të bardha me xham të trashë.

«Lexon shumë i paudhi. E marrtë lumi diturinë e tij...» — u mat të thoshte plaku.

Todi dhe Lira u panë sy në sy për një çast. Buzët e saj të trasha sikur lëvizën për të thënë diçka.

Atë kohë kamioni po mbushej me djemtë e kurasë. Todi u përshëndosh me fshatarët. U për-qafua e u puth me xha Uanin dhe me Gorën. Pastaj i shtrëngoi dorën edhe një herë kujt do që gjeti para.

Nëna i vinte rrotull dhe i shkante pas ngado që çapitej.

— Mjaft, nënë. Hajde ndahemi njëmen. Për mua mos ki merak. Shiko shëndetin tënd. Edhe Gora do të të ndihmojë. E ke mbështetje. S'do të lerë vetëm, sa të kthehem unë... — tha Todi, jo pa qëllim.

— Po, po, biro. Ashtu tamëm...

Gorës i qenë mbushur sytë.

— Hajde, mirupafshim, nënë!

Nëna e uthi në të dy faqet dhe ai ndjeu ngrohtësinë e frymës së saj në fytyrë; ndjeu edhe krahët e saj, që dridheshin lehtë, tek i fërkonin shpatullat. Edhe kur u kthye të ikte, ndjeu se ata krahë i qëndronin mbi shpatullat, bashkë me shikimin e atyre syve të futur thellë, që nuk nxorën pikë loti. E pse të nxirrnin?..

— Dhe hap sytë, ta nderosh nënën, bir... Të nderosh emrin e babait... Të na nderosh të tërëve.

Tek ikte për në kamion, ndjeu, pas këtyre fjalëve, sikur i rrihnin mbi shpatulla dy duar të ashpra, që zgjateshin, zgjateshin.

«Të rrita, të bëra burrë — mendonte nëna. — Të mësova të punosh tokën, të rritësh bagëtinë, të nderosh njerëzit... Po, për ushtrinë s'dija e mjera ç'të të thosha... Apo më doli nga mendja kjo?.. Bëj vetëz njëmend, t'u bëftë nëna!...»

Todi hipi në kamionin që kish nisur të lëvizte. Një vuvurimë e shurdhër e mbështolli aty brenda. Zgjati kokën dhe thërriti me zë të lartë, për të mundur çdo zhurmë.

— Mirupafshim! Mirupafshim!

Kjo përshëndetje, që doli nga kamioni i mbu-



luar me mushama, mori arratinë nëpër fushë. Ajo u drejtohej gjithë njerëzve, arave të pluguara, pyllit me shpesë, detit, ajrit, gjithë ç'përmbante kjo natyrë, gjithë ç'përmbante kjo pjesë toke, në sipërfaqe e në thellësi.

Ajo përshëndetje do të vazhdonte të vinte me jehonën e hapit ushtarak, nga horizontet e largëta gjer këtu.

Kamioni mori shpejtësi nëpër tragat, që të nxirrnin në fushën e gjerë, e cila ngjante për së largu si e përmbytur... Prapa kamionit, u ngrit një bisht i gjatë pluhuri, që pastaj varej si një cipë vuali mbi çdo gjë.

Pylli me pishë, shtëpitë grumbuj-grumbuj, ugaret dhe lapidari, që zbardhëllente, nisën të largohen.

Todi ndjeu sikur iu mblodh diçka në fyt dhe s'po e kapërxente dot poshtë; ndjeu një dhëmbje, që më pas i mbështolli gjithë gjoksin. Ishte dhëmbja e ndarjes. Ai s'e kishte provuar ndonjëherë.

— U mallose shumë, ë? — ja bëri mu te veshi një nga shokët.

Dhe nuk u kuptua në se Todi pohoi me kokë, apo koka lëkundej vetë nga troshitja. E vërteta që se ai u turpërua dhe u përskuq në fytyrë. Nuk i vinte mirë që u tregua i dobët në sy të të tjerëve. Por malli i ndarjes nisi të tretej e të largohet, sa më tutje bënte kamioni nga ato vende të njohura. I mbeti në mendje vetëm figura e nënës, me dorën e zgjatur lart, që shquante edhe përmes pluhurit, me rrobat e saj të zeza, atje pranë lapidarit që vezullonte. Të dy ata, nëna dhe lapidari, ngriheshin më lart se çdo gjë dhe ndiqnin pas

kamionin e mbuluar me mushama, me tri parulla të kuqe.

Rekrutët flisnin me zë të lartë. Ata lëkundeshin e mbështeteshin trup pas trupi. Pastaj nisën të këndonin për ushtarin.

*Në të dalë të fshatit  
djalin përqafova,  
me shami të kuqe  
gushën ja mbështolla...*

Melodia vërvitej prapa dhe mbetej udhëve fushore.

## II

Nën kapotat e murme, me rrip të ngjeshur fort pas mesit, ushtarët ngjasonin shumë me njëri-tjetrin. Dukeshin sikur i kishte prerë një gërshërë, sikur i kish bërë një nënë. Hidhnin një hap dhe thoshin një fjalë: «Si urdhëron!»

Po bëheshin tre muaj që kur ushtarët e rinj kishin nisur stërvitjen së bashku me të vjetrit. Toga e tretë shquante për rezultate të mira. «Si urdhëroni!» Kjo fjalë dilte nga goja e ushtarëve pa rreshtur dhe shembëllente me një skuadër në një rresht të ngjeshur, me një pushkë të gjatë në shpinën e ushtarit të fundit. «Si urdhëroni!» Kjo fjalë shprehte hapur gadishmërinë e tyre, në përgjegje të thirrjes së Atdheut. «Si urdhëroni...»

Tre muaj shërbim ushtarak nuk janë pak. Mirëpo prapë ajo dita e parë nuk harrohet lehtë.



Bile, për disa, ajo mbetet si një kujtim i veçantë në jetën e ushtrisë...

Rekrutët kalojnë njëri pas tjetrit, të ngathët, ashtu siç e kanë zakon të ecin njerëzit, nëpër udhë të reja, të panjohura. Duken ca të turpshëm dhe më të rrallë këmbëjnë ndonjë fjalë me zë të ulët, duke buzëqeshur fshehtëzi. Herë-herë ngrenë dorën, fërkojnë kokën dhe ndjejnë gudulisje të këndshme nëpër flokun e qethur. Nga koka ngjajnë të gjithë njëlloj, ndërsa veshmbathja e tyre është akoma e larme, e vjetëruar dhe çyryke: e zbardhur nga dielli, e ngushtë, e shkurtër.

Atje te dera e madhe e depos, mbliidhen turmë dhe pastaj një nga një dalin përpara kujdestarit që i vëren nga koka te këmbët dhe u lëshon te praku një deng me uniformë. Ata e rrëmbejnë atë deng nën sqetull, pa e shkuar në mend se aty brenda është mbështjellë një jetë e panjohur. Dhe ikin, ashtu siç erdhën, njëri pas tjetrit, duke ndjerë erën e depos që mbajnë teshat. U duket sikur të gjithë i shikojnë dhe e kanë fjalën për ta.

Mbi territorin ushtarak, me godina të vendosura përçark një sheshi të madh, ngrihet një tym i rëndë qymyri. Banja është gati. Banja e parë në ushtri. Rekrutët dalin nga banja. Dengu me tasha është zgjidhur. Ata s'janë me rekrutë: janë ushtarë të rinj. Kanë ndryshuar së tepërmi dhe vështrojnë me habi njëri-tjetrin. Ecin me ndrojtje aty rrotull, se këpucët e reja me gozhdë mezi përthyhen. «O, sa të rënda këto këpucë! Mezi hedh këmbën. Ku vrapohet me këto?!» Duart s'dinin ku t'i çonin. Dhe bënin ç'bënin tërhiqnin rripin, trazonin pullat ose bënin sikur ujdin bustinën.

Todi kish ngelur mënjanë, pa e vënë re as vetë se si. Brenda territorit ushtarak, kish nisur të ndjente veten ngushtë. Ai qe mësuar në fushë, ku e hidhte shikimin larg, në të katër horizontet e hapëta, ku kish të bënte me ugaret dhe bimët. Ndërsa këtu, sheshi i dukej i thatë, i ngjeshur e shterpë. Dhe vriste mendjen: ç'mund të bënte ai brenda këtij sheshi?

«Veglat gjimnastikore dhe brezin e kalitjes i njoh, po këto të tjerat ç'të jenë?» i kishte thënë një ushtar i ri.

Dhe ai vërente me kujdes gjithshka që i zinte syri përçark. Në disa hekura të lartë vareshin litarë të trashë. Në disa të tjerë akoma më të lartë, qenë vendosur ca si çadra shiu, të lidhura me kavo. Më tutje, si ndonja tre metra mbi tokë, një si trup aeroplani qe varur, edhe ky në kavo të trasha. Aty pranë, kishte trampolina gjer në pesë-gjashtë metra, por nën to ishte sheshi i fortë dhe jo ujë. Në mur të një godine, larg, dukej një aeroplan i pikturuar dhe, poshtë, nën bishtin e tij, parashuta të bardha në qiellin e kaltër.

«O, sa shumë gjëra të panjohura paska në këtë shesh të ngushtë e të rrahur nga këmba e ushtarit!...» Kushedi sa vështirë do ta kemi!...» mendonte Todi tek hidhte sytë përçark dhe atë kohë i shkante mendja te letra e parë, që duhej të niste për në shtëpi. Këtë letër e prisnin dhe ajo duhej shkruar me doemos. Po ç'të shkruante?

Ushtarët e rinj vinin përçark, pa u larguar shumë nga njëri-tjetri. Kujdestari, që mbante ca regjistra në dorë, i mblodhi të gjithë në rresht. U foli diçka dhe u shpërndau gjilpërat.



— Gjilpëra mbahet në bustinë — ja bëri. Dhe e nisi togën me komandë. Ishin hapat e parë rreshtorë me uniformën e re. Ecnin për bukuri. Mirëpo kujdestari e prapsoi togën tri herë rresht dhe, për habinë e ushtarëve, prapsimi bëhej po në një vend.

«Ç'është kjo punë? Sa vështirë do ta kemi!..»

Kujdestari kishte parë se një ushtar i shmangej një pellgu të vogël me ujë, ruante këmbët dhe prishte rreshtin.

Këto qenë disa nga përshtypjet e para, që ushtari i ri, edhe pas tre muajsh, nuk i kishte harruar. Dhe ndoshta për tërë kohën e shërbimit nuk do harronte gjësendi nga këto.

Ishte një ditë e diel me shi, një ditë nga ato të mërzitshmet, që të mbyll brenda e s'të bën zemra për asgjë. Gjithë ushtarët e togës së tretë qenë futur në dhomën kulturele dhe atje merreshin me lexim dhe me se të mundnin për t'u argëtuar.

Todi bënte ç'bënte dhe dilte jashtë. Kur kthehej sërishmi, nxirrte bustinën nga koka dhe e përplaste në pëllëmbë të dorës për ta shkundur, pastaj e fuste në rripin e mesit, siç bënin zakonisht gjithë ushtarët. Zinte një vend dosido dhe që aty vërente e dëgjonte në heshtje.

Ushtarët e vjetër të togës i dukeshin sikur paskeshin lindur ashtu, ushtarë. Ndonëse edhe ata kishin nga një send që i dallonte: kishin ndonjë histori, ndonjë vepër, kishin edhe qyfyre nga ato që u pëlqejnë të rinjve.

Lirimi e kishte bërë Todin për vete që ditët e para. Ishte një djalë i çuditshëm, me sy të kal-

tër e buzë të lira, që fliste e qeshte njëkohësisht. Të gjithë e donin dhe e ruanin miqësinë me të. Todi, nga ana e tij, zuri të ndjente edhe një farë xhelozie për shokun e togës. Donte që shoqëria e tyre të shquante mbi të tjerat. Mirpo Lirimi, që kishte punuar në jetën civile si gjeometër, ishte mësuar ta ndante dashurinë me të gjithë.

«Ç'më shtyri me këtë njeri? Mos vallë nga që i përngjet disi Lirës?!..» mendonte Todi dhe qeshte me vete «Ç'budalla që bëhem!..»

Edhe Lirimi, si gjithë ushtarët e tjerë më të vjetër, kishte historitë, veprat ndoshta edhe qyfyret e tij. Gjurmët që kishte lënë ai gjatë një viti, nuk qenë të pakta. Lulishten e repartit e kishte projektuar për bukuri. Ai thoshte «Normat e vetë grososjes së ushtarit janë të mëdha». Dhe vetë me një skuadër shokësh i theu këto norma e vendosi të reja. Ai ishte një ushtar këmbëngulës gjer në fund në debatet, që lindnin në mes të shokëve, qofshin edhe ato me pak rëndësi. Vetëm karshi kokëfortësisë së Marashit ai tërhiqej heraherës. Dhe këtë e bënte me qëllim, se kështu Marashi, më në fund, i bindej. Mirëpo në këto raste kërcente përpjetë e merrte flakë Gjoka, të cilin toga e thërriste «nxënës i Lirimit», meqë donte të mësonte për gjeometër. Ai s'përmbahej pa i thënë.

— Kot e ke, Marash. Ti u tregove «i pabindur» dhe pikë.

Marashi s'deshi të futej i tëri në llogore se gjyshi i vet e pat porositur dikur: «Mos na korit! Ballin mos ja fshih anmikut...»



Komisari mund ta urdhëronte Marashin që të kridhej në llogore, dhe ai, «i pabinduri» do ta plotësonte urdhërin, po komisarari e kish bërë zakon, që në këto raste, të fjalosesh gjerë e gjatë me ushtarin:

—...Po kjo është tjetër punë, mor Marash. Gjyshi yt ka pasur hakë dhe të drejtë... Ne nuk i trembemi plumbit. Por ne duhet të shtrijmë përtokë dhjetë armiq, njëqind armiq. Të shtrijmë sa më shumë. Sa të na mjaftojnë fishekët, sa të na çahet tyta e pushkës, sa të na shohë syri e të lëvizë gjaku në rrëmba. Kështu, mor Marash. Dhe për këto ne do mësojmë shumë. Dhe do vijë koha kur ti do shkosh në malësi e do t'u rrëfesh të tjerëve...

— Kot e mërzite komisararin... — i thosh Gjoka.

Sakaq mendimi i Marashit po kthjellohej. Ai zuri të tundte kokën në heshtje. Vetullat e ngritura, ato pak rrudha të ballit dhe çipat e zgjatur të buzëve tregonin se ushtari po kërkonte të gjen-te diçka.

Çfarë nuk dëgjon, në dhomën kulture!

Doemos aty, në radhë të parë, do dëgjosh të bëhet fjalë për shqetësimet e detyrës ushtarake, për lodhjen, për suksesin.

Ndonjë nis të kritikojë shokun e skuadrës:

«Na pengove, — i thotë, — ne do të kishim fituar garën në brezin e kalitjes».

Tjetri turpërohet, ul kokën për një çast.

«Do ju vijë edhe juve dita» — thotë me shaka një ushtar.

Aty në atë dhomë, ushtarët njihen më nga afër me shoku-shokun. Flasin pa ndroje, sikundër vëllai me vëllanë, në daç edhe më tepër. Ata që hanë e flenë së toku, s'kanë ç't'i fshehin njëri-tjetrit. Ata që kanë një detyrë kaq të vështirë e të lartë, pse të mos hapen në ndjenjat dhe shqetësimet personale?

Dhe kështu ndonjëri sillte aty, në dhomën kulturale, prindërit, vëllezërit, motrat... gjithë të njohurit. Ajo copë jetë, që kishin bërë gjersa qenë veshur ushtarë, shfaqej në kuadro plot dritë.

— Babanë e kam ca të ashpër — tregonte Lirimi. — Më kujtohet ajo ditë kur ika. Kur e pa nënën të përlotur, ai u ngërdhesh. Unë e vura re dhe prisja ç'do të bënte ashtu, në mes të njerëzve. Por babai nuk është i pamatur. Vetëm zemrat, që preken shpejt, s'para i ka qejf. Nuk do lot ai, as në gëzim as në hidhërim. E kapi për krahu nënën, që është një natyrë fare e butë, e prekshme dhe mua ma bëri:

«Hajt, nisul!» duke më bërë shenjë nga maqina e mbushur me rekrutë...

Një turmë ushtarësh e kishin rrethuar Lirimën dhe e pyesnin:

— Vërtet të tha «nisul»?

— Vërtet, posi, — përgjigjej ai pa të keq.

— Dhe s'të puthi?!

— Më dha vetëm dorën.

— Oh! — ja bënin disa të mallëngjyer.

Lirimi vazhdoi:

— Duhet t'ju them ama, se letrat që më shkruan babai s'do mund t'i shkruante askush. Ndonjëherë do t'juja lexoj. Me fjalë të kursyera më flet për



të gjitha dhe më mëson. S'ka shumë kohë, që më çonte një porosi: «Shiko, — më shkruante, — lexoje mirë atë artikullin mbi klasën punëtore, dëgjove?»

— Ashtu të shkruante? — pyeti njëri.

— Pikë për pikë, siç ju thashë.

— Me sa duket, ai nuk e di, që ne i studjojmë fill e për pe artikujt — tha një tjetër.

— Nga do ta dijë — ja bëri Ali Kërçelli. — Ai qymyrxhi është.

— Është minator në Memaliaj.

— E, po ç'bëri? — tha prapë Aliu.

Një copë herë nuk foli asnjëri.

Todi që afruar aty, pa e kuptuar as vetë se si. Qëndronte më këmbë në atë rreth, që ishte formuar për qark Lirimit. Rrinte ca i hutuar dhe thuajse mendja i bridhte kushedi se ku gjetiu.

Atë të diel, ushtarëve nuk u kishte ecur. Tërë ditën shiu nuk kishte reshtur dhe ata qenë mbyllur brenda. Ç'të bënin që të dilnin edhe në qytet. Veç shiut që rridhte, s'kishin për të fituar asgjë tjetër. Mirëpo me shiun, baltën e të ftohtit tërë javën u ndeshën nëpër fushat e stërvitjes dhe qenë mërzitur. Ndaj patën vendosur më mirë të rrinin së bashku, atje në dhomën kulture. Ky që një vendim i pahedhur në votë, një vendim i marrë në heshtje, ashtu siç ndodh dendur me ushtarakët. Kjo, natyrisht, ngjet atëhere kur ushtarët kanë nisur të bluajnë të vetmin mendim: si të shërbejnë më mirë.

Todit, për një kohë, iu duk se po e pushtonte një mërzitje e pakuptuar, që zuri ta shqetësonte dhe, për ta zbuar më tutje, ai bënte ç'bënte e dilte përjashta.

«Qysh folkan këta kështu, mbarë e prapë?..»  
— vriste mendjen ushtari dhe ishte vetë që gjente një arësytim për t'u dhënë hakë shokëve.

«Janë bërë si vëllezër... Kanë më shumë se një vit që jetojnë bashkë».

Atë ditë ushtarët mësuan se Todi dikur, në jetën civile, ishte marrë me bujqësi. Tërë atë copë jetë vetëm me bujqësi dhe, ndoshta, siç u kishte thënë ai, për asnjë punë tjetër nuk i jipej. Vetë ushtarët, nga ana e tyre, pikasin te shoku një avashllëk, ngadhtësi e ndruajtje, por, në një kohë, shikonin se ai mund t'i bënte të tëra. Ata dëgjuan pak fjalë për prindërit, për motrën, për xha Uanin, për një shoqe fëmijërie, që qe bërë shofere...

— Me atë ke gjë? — e kishte pyetur një ushtar.

— Me cilën?

— Me atë de, që na the: Lirën...

Ushtarit nuk i erdhi mirë. Ndoshta mendoj se ky do qe sekreti i vetëm i tij ndaj shokëve të togës. Ushtarët pikasën se si fytyra e shokut u përskuq gjer te veshët dhe ai kokëulur, duke shikuar majat e këpucëve, s'dinte ç'të thoshte. Për një çast, u duk se nuk ja kish qejfi ta shtynte bisedën më tej. Ai lëvizi vendit i heshtur. Sidoqoftë, në fshat jetonin njerëzit e tij, që i çonin për së largu gëzim dhe shqetësim. Ata i njihte mirë, ashtu si edhe arat, pendët e qeve, traktorët, viçat larushë apo maqinat korrëse, që dërgonte SMT-ja. Atje kishte njerëzit e dashur. Kurse në ushtri puna qëndronte ndryshe: plot armë, sheshe të ngjeshura e të rrahura nga këmba e ushtarit, vegla të shumta gjimnastikore. O, sa vegla! Në një nga



ato vegla, ai s'do hipte kurrë me dëshirë po të qe në fshat. Ajo është një vegël e çuditshme me dy rrathë të mëdhenj. Atje të lidhnin, kur hipën, e të rrotullojnë, të vërtitin nga të katër anët. Dhe, kësisoj, toka e qielli bëhen njësh e të bytyntë. «S'më vika ndoresh për këto gjëra... Se ç'kanë edhe ca emra, që mezi mbahen mënd këto vegla: xhiroskop, lavjers, trampolinë, kalë, kaluç... Ç'emra! Edhe ai trampolini tremetrësh s'është i pakët, jo. Kur hidhesh që andej, të ngjan sikur të lëvizin gjithë koskat e trupit dhe veshët të buçasin. Hidhesh në tokë të thatë».

Në mbrëmjen e një të diele, Todi vendosi të shkruante letra. Për Lirën i kishte mbledhur e qimtuar thuajse tërë mendimet: «Sa shumë njerëz kam njohur! Ti s'e merr dot me mend ç'qenka ushtria. Sa shumë kemi për të bërë aty në fshat!.. Sa shumë libra ka këtu (veç rregulloreve). Këtu ka një lulishte të bukur, që e kanë bërë vetë ushtarët e vjetër. Them të mësoj si mund ta bëjmë edhe ne, aty te lapidari... Do të të rrëfej plot gjëra, që duhet të bëjmë ne në fshat... T'i dish edhe ti se, kur të kthehem, kushedi edhe mua më zë gjumi si të tjerët... Dhe ti, Lirë, të më përmendësh: «Ej, ushtar — do më thuash, — zgjoui!...»

Todi ndjehej i kënaqur dhe qe i bindur se sytë e Lirës kishin për të marrë një shkëlqim të gjelbër, kur të lexonin ato radhë. Sigurisht, në këto raste, pasi mbaronte së shkruari dhe numëronte të falat për bashkëfshatarët, në kokë i rridhnin kujtime të asaj jete.

Atje, po... Atje, me tokën, dinte si të bënte...

### III

Para se të vente në ushtri, Todi kishte punuar në kooperativë.

Bujqit ishin të dhënë pas punës. I rrinin tokës, si i thonë një fjale, mbi kokë. I bënë hyzmetin si duhet. Vetëm se nuk shqiteshin dot nga ai mendimi, që akëcila arë nuk bën prokopi, sikur ta punoje sa të të dilte shpirti, t'i hidhje pleh sa të doje, more, edhe nga ai kimiku, që thonë se e nxjerr bimën edhe në gur, prapëseprapë s'dilte gjë nga ajo arë.

Ndanë fshatit, jo shumë larg nga arat e punuara, nis ajo fushë e shkretë e paanë, që, bashkë me detin nga ana tjetër, e bënë atë fshat të qëndrojnë i veçuar si një oaz. Dimrit teptis uji dhe bëhet njësh me gjolin, kësisoj rruga për të dalë në xhade zgjatet dyfish, duke kaluar përçark. Pastaj, më të hyrë të pranverës, zë e shteron ca nga ca.

Todi e shikonte me ankth atë fushë, sa herë që kthehej nga arat për në fshat. Ai kishte dëgjuar edhe sharjet e bujqve të moçëm që i drejtonin asaj dhe gjolit aty pranë.

— Pfu, shtrigë! se ti na e bije gjithë palavinë e prapësinë. Dëgjon? Po ai kaçatori, ta bëri varrë! E bekoftë zoti, se na shpëtoi nga ethet!...

Kishte dëgjuar edhe të tjerë më të rinj, që prisnin, se kur do t'i vinte radha edhe kësaj fushe, që të jeshilonte.

— Në planin tjetër fillon bonifikimi, e di mirë unë...

Aty nga mbarimi i marsit, kur nisnin e shteronin ujërat e ndenjura niste edhe ai avazi plot



zhurmë i bretkosave. Dhe, për tërë gjysmën e parë të natës, fusha anembanë buçiste nga kuakjet. Nën dritën e hënës, ajo zhurmë ngjante sikur vërvitej lart nga sipërfaqja e dheut.

Në një mbledhje që u bë në kryesi të kooperativës, Todit nuk iu durua më dhe propozoi:

— Ta provojmë një herë, mbase i shqitim ndonjë copë arë, asaj fushe.

Të paktë qenë ata që e përkrahën. Bile, vetëm sekretari i partisë, që ai, që u kap pas mendimit të Todit dhe tha:

— Ne duhet të dalim para kooperativistëve, me një propozim të shkoqitur mirë. Për këtë le ta rrahim çdo gjë veças dhe pa thartuar trutë. Ju që s'jini në gjendje të qëndroni sonte, shkoni në shtëpi, trembeni një herë gjumin dhe ktheuni, kur të jini gati. Unë dhe Todi jemi këtu gjersa të zbardhë.

Leksi, sekretari, ishte bërë shok e shkuar shokut për Todin... Ai ishte shpërngulur me gjithë familjen nga fshati, menjëherë pas luftës. I vëllai, rreth të pesëdhjetave, që ish bërë oficer dhe shërbente në një repart aviacioni, njeri i lindur dhe i rritur nëpër afshin e bujqësisë, e dërgoi Leksin në shkollë bujqësore. Që andej e nisi në fshat, te xhaxhai, Pilua.

«Atje e kemi vendin ne, — i kishte thënë të vëllait — Punëtorë të kësaj toke jemi të tërë... Po nuk vajtëm ne në baltë, kush do vejë?...

Atë natë, Leksi kaloi disa herë nëpërmend të anë dhe kujtoi fjalët e tij: «Mos më merrni në qytet, or bir, se atje do ta kem të shkurtër... S'kam ç'rëmoj atje...» Kështu u pat thënë dhe vërtet nuk

e pati të gjatë... Nga mërzitja nisi të prashiste drunjtë e trotuarëve dhe ata që e patën parë, me siguri e patën kujtuar të lojtur nga mendtë.

Ndaj të gdhirë i ra ndër mend dhe i tha Todit:

— Babai thoshte se kjo tokë, — dhe tregoi, me majën e kalemit fushën shterpë të vizatuar në letër — nuk mbulohet e tëra nga uji i kri-pur. Ka edhe ujë të ëmbël.

— Po, po. Ashtu është. Dhe, në fund të fundit, ja, një kanal pesëqind metrash na lipset dhe e lidhim me pellgun e kallamishteve.

Të nesërmen, bujqit u mblodhën te sheshi grumbuj-grumbuj. Kishin vajtur të gjithë dhe pëshpërisnin me zë të ulët për atë mbledhje të papritur; pëshpërisnin edhe për Isanë, që kishte dalë nga shtëpia e vetë, tamam si një hije.

— More, le të tjerat, po ç'të përmbysim, që Isai paska lënë dyshekun në këtë cingërimë e athëtimë?

— Hi-hi-hi qeshnin në mes të grumbullit dhe shikonin Isanë verdhacuk me syza, që u kujtonte Xhezon, me atë hundë si kokër fiku.

Uan Kërri travatiste përçark lapidarit të bardhë dhe thëthinte duhanin e trashë. Ai i kishte marrë vesh të tëra.

Njerëzit hynë në sallë.

Në fillim, ra qetësi dhe tymi i kaltër i duhanit u vërvit gjer në tavan. Dëgjohej zëri i kryetarit, që fliste ca përgjumësh, dhe një kollitje e ngjirur me gëlbazë, që çante ajrin e tymosur.

Uan Kërri që ulur në një qoshe me Pilon. Mbante mbi gjunjë, ashtu i ulur këmbëkryq në një



arkë, çomangën prej marine. Ngjante sikur kishte ardhur për sehir, se të tëra i dinte.

Pëshpëritje në sallë. Kollitje. Ca kruanin gurmazin kot më kot.

— Frëngjuzi u zëntë! — u dëgjua një zë nga mesi. — Ç'dreqin kini?

— Kush ka gjë për të thënë, le të ngrihet — tha kryetari.

Sekretari, përmes asaj mjegulle të vërtetë, hetonte fytyrat e kooperativistëve. Ai buzëqeshi.

— S'është nevoja të ngrihet. Le të flasë ulur po të dojë; ne duam fjalën, s'duam ta shohim; apo jo?

— Mirë, po s'kemi qysh t'ja bëjmë, se do na shajnë femrat, që s'i kemi këtu — bëri shaka dikush.

— Pse s'i muart? Ato që deshën erdhën...

— Të tëra të mira janë, po dhalla mbetet dhallë... — hodhi shaka një tjetër.

— Ty të është bërë koka si fërric plepi dhe nuk di ç'thua, ore djall.

— Dy fara tru ka ai, një të thatë e një të mpitë...

— Nisët si ato mizat në qyptë, o të uruar! Ç'janë këto?... Ç'plasje u rroi?! — ja bëri ai që hodhi shakanë e parë, një burrë plak, kuqalosh, me buzë të trasha, që dukeshin sikur mbllaçitnin petulla tërmon. Me faqet e parruara, si hamullore, nën rrezet që hynin nga dritarja, ai u çua në mes të sallës dhe vazhdoi:

— Unë s'di llafe. Llafet janë fukarallëk dhe ne i sikterisëm ato me fukarallëkun. Po si e pabërë më ngjan qo, që thua, o kryetar. Do na shkojë

dëm djersa, në atë tokë varfanjake edhe koqja e misrit do jesë për krimba. Ç'na lipsen këto marifete... s'jemi keq për bukë, de... S'na zaptuan nga deti, që të shtyhem në atë shtrigë të handakosur. S'mbetëm keq, de, që të kridhemi në moçal...

Todi rrinte me kokën mënjanë. Leksi e shikonte herë pas here dhe seç i bënte shenjë. Ai i kishte thënë që më parë:

«Duro, shok i dashur. Nuk është kollaj të bësh atë që s'është bërë ndonjëherë. Ne duhet t'i dëgjojmë me gjak të ftohtë edhe sharjet, pa na u skuqur veshët dhe të shkoqitim kush duhet bindur, kush duhet shtypur si morr...» Dhe atë çast atij i dukej sikur vetë Todi i thoshte: «prit se ka edhe më keq.»

— S'bëhet dhalla mullar, or, jo...

— Bëhet kur është në tuncë...

— Si, ore, s'u bëka?!

U ngrit një burrë i shkurtër, i kaluar në moshë. Mjekra dhe leshrat i qenë zbardhur e bërë njësh. E kishin mbuluar thinjat. Fytin e kishte mbështjellë me peshqir. Vetëm fytyra e zeshkët dhe takija në majë të kokës dallonte.

— Nuk është keq të zgjerohemi. Ngushtë jemi: nga një anë pylli dhe deti, nga tjetra fusha e shkretë dhe gjoli, Pellgu i kallamishteve... Po s'jemi të zotët ta bëjmë ne atë. Nuk është kollaj. Një fjalë goje është të hapim një kanal e ta lidhim me ujin e ëmbël të lumit të vdekur, atje te Pellgu i kallamishteve. Po ecë e bëje, të kam rixha. Ku të lënë punët e tjera? Do kemi dëm. Pastaj misri s'e honeps fare kripësirën. Ai i uruar



kudo mbin, po nuk të jep kudo kalli dhe kallame...

— Tamëm, tamëm, — ja preu llafin një tjetër me cigaren në gojë. — Pse Rustem Agai, na marrtë të ligat, s'donte të zgjerohej, apo i dhim-seshin krahët tanë?...

Uan Kërrin s'po e zinte vendi. Vërtet ishte e zorshme ajo që thoshin, mund edhe të mos dilte gjë nga ajo tokë e zhuritur, po ç'qenë ato llafe? Ç'djallin i kish gjetur? Sikur u kishin vënë zjarrin nga këmbët. Le ta provonin një herë. Pilo Kulari që rrinte pranë tij seç i foli në vesh.

U ngritën ca të rinj. Ata flisnin me zë të lartë. Ishin bashkëmoshatarët e Todit dhe kishin një mendim me të. Përdornin edhe ca fjalë, që pleqtë s'para i kuptonin si «agroteknika», «eksperienca e përparuar» ose «plenumi» e të tjera dhe angazhoheshin secili për pjesën e vet.

Kooperativistët sikur u zgjuan nga përgjumja, nisën të kuptonin diçka. Disa u ngritën e mbështetën menjëherë të rinjtë. Të tjerë pëshpërisnin me gjallëri.

Vetëm ata, bujqit e moshuar, që folën në fillim dhe ca të tjerë, që ishin në një mendje me ta, sikur varën buzët.

Sekretari i partisë rrinte i qetë, fare i qetë. Buzëqeshte dhe më të rrallë trokiste në tavolinë me fundin e kalemit. Dukej sikur hetonte çdo fytyrë dhe tregohej i kënaqur.

Uan Kërri hodhi sytë nga Todi dhe, kur e pa të vrenjtur e të sertë, mendoj: «nga tiparet gjallë i ati është, po e ëma i ka dhënë shpirtin...»

Isai, me sa duket, qe i gëzuar për «dy frontet», që u krijuan në atë mbledhje dhe mori kurajë

e u ngrit. Gjer atëhere, asnjërit nga bujqit nuk i kish vajtur në mendje se aty brenda ishte edhe ai.

— Tokë shinterpë ajo — nisi Isai. — Ta provojme, nuk është keq, po zahmet, zahmet se nxjerrim gjë. Pleqtë e thanë drejt llafin e tyre. Janë të vuajtur ata. Gjer më sot fjala e pleqërisë e ka drejtuar mirë fshatin. S'duhen hedhur tutje pleqtë — tha dhe heshti. Kasketën e përdridhte në dorë siç shtrydhet një rrobë e qullur.

— È?.. Qysh tha, ore?!

— Pleqtë..

— Pse, kush i hodhi pleqtë?

— Ç'dërdëllit ky, ore?

— E shikon ti? Dalin prapë mizat pas shiut...

— Kojja e breshërit i fut në dhé ato.

— As ajo. Se futen në dhe para furtunës ato. Ohu, sa e ndjejnë kohën e keqe ato!

— Ne thamë se vunë mend e i futëm në kooperativë. Po s'harrojmë ne, jo..

— Eh, qysh vete! — ja bënte ai qimekuqi i parrojtur. — Kujton se na bën për vete, si atëhere qy... He, he, hee!... «Po, ti, o i uruar, pse i çon detyrimet, — më thosh, — s'kanë ç'të të bëjnë ty... Ti i këputur ke qenë...» Dhe unë, ke parë ti? E haja! Hajde kokë, hajde!... Nuk ta bën borxh ai surrat laço?..

Pëshpëritje pa fund. Romuze.

Isai nisi të sqaronte diçka. Syzat i shkrepnin si sytë e maçokut. Qëndronte përballë dritës, që vinte nga jashtë dhe përngjante si një furkaqe marine.

Uanin s'po e mbante vendi.



— Sikur ke shtruar ferrë nën vete, o, Uan,  
— i tha në vesh Pilua. Uani kërceu nga vendi.  
Lëshoi cigaren e trashë te këmbët dhe çau për-  
para. Ngjante sikur do vërvitej mbi të tjerët. Në  
ecje e sipër nisi:

— Ne pleqve na kanë rrudhur trutë...

— Ama ç'e the mirë, o Uan!

— Pastaj, or ti mik, ne pleqtë për kuvende  
jemi... — thumboi Pilua, duke shikuar nga ana  
e Isait.

— Kështu s'na ka ngjarë ndonjëherë. Sot  
ç'djall ju gjeti? Se qysh e muarët ters... Ju kanë  
zënë xhindet... Do ta bëjmë apo qysh? Apo do  
rrimë pas hirit, nëpër brekët e plakave? Ç'plasje  
ju rroi?!

Ca të reja, që ishin andej nga fundi i sallës,  
u skuqën, kur dëgjuan fjalët e fundit të Uanit,  
Edhe djemve, që ishin pranë tyre, s'u erdhi mirë.  
Po prapë i jepnin hakë xha Uanit.

— Tamëm, e ka mirë, — e ndërpreu ai që foli  
në fillim fare, me atë mjekrën si hamulllore. —  
Kot u përzie muhabeti. Vërtet sikur na zunë xhin-  
det, lanet qofshin!

— Lërini ato fjalë. S'ka xhinde, jo — u hodh  
një i ri me zë të lartë.

Të tjerët nisën të përkrahnin Uanin. Ishin të  
moshuar të tërë. Ai mori çomangen nën sqetull  
dhe u kthye te vendi.

— Isai na thënka se është gjë që s'bëhet kjo.  
Pale, na thënka se kemi hakë ne, që folëm kund-  
ra... Ja, de, ku janë xhindet!...

— Hë, ore, ç'i dëgjon fjalët e tij. Isait i kanë  
luajtur burgjitë.

— Dikur dërdëlliste se i dhimseshin bujqit...

— Hë, ore, se llafe ka ai... S'të kafshon...

— Mos e thuaj atë... Po s'e mbajte shkopin ngritur, qeni të turret. E harruat Xhezon?..

— E, po, kur shpëtoi lugati! Kur s'e hëngri të së ëmës atëhere me të anë!

Ata, që ca më parë kishin varur buzët, qeshën. Të tjerë po mendonin. Mendonin për njëri-tjetrin, mendonin më tepër për Xhezon, për Isanë, për ato kohëra, kur ballistët e Barushit sorollateshin këtyre anëve dhe për një pulë vrisnin një fëmijë.

Shtëpia e verdhë e muhaxhirit ishte e vetmja, që nuk pa trazirë gjatë luftës. Ballistët e Barushit, që travatisnin atyre anëve, nuk shkelën asnjëherë për be në oborrin e Xhezos, pa le të futeshin nëpër kotecë. Ata sikur i kishin me listë vendet ku shkonin.

«Ore, po paska qenë vakëf ai truall... Qysh ja lamë muhaxhirit atë vend! Të kishim ngritur kasollet tona atje, beqma do shpëtonim nga Barushi...» ja bënë bujqit me qesëndi!

Vetëm në kohën e Italisë, mbahet mend nga bujqit, shtëpia e Xhezos nuk gjente rehat nga një *tenente*. Ai vinte nga anë e anës kaluar në kalë të lartë, që i vetëtinte qimja dhe thërriste dy herë në ditë: «*Signora, signora! Aveté uova, signora!*»

Nuk dihet në i pëlqenin *ovat* e pulave të bardha, atij *tenentes* së pispillosur, që ngjante sikur ja kish lëpirë viçi flokët, apo *sinjora* bardhoshe e Xhezos, që s'e kish parë dielli i Myzeqesë. Ajo mbante përherë çarçafë dhe që andej, nga të zgritat, shikonte botën. Që andej e shikonte edhe *tenenten* majë kalit, kur i lëshonte në dorë



ovat. Pastaj, mbyllte portën dhe, me nxitim, duke hedhur vithet nga një anë në tjetrën, shkonte pas penxheres për të parë më mirë *tenenten*. Kali i tij shkrofëtinte dy-tri herë dhe niste trokun fushës, ndërsa pela e Xhezos dridhte bishtin brenda gardhit dhe hingëllinte me tërbim.

Aty nga fundi i vitit nëndëqind e dyzet e tre, në shtëpinë e verdhë, u kthye Isai, që kish qenë student jashtë shtetit.

Thoshin se Isai, i biri i Xhezos, që e kishte me grua tjetër, ishte njeri me kalem, me shkollë të madhe. Pastaj s'dihej se nga dilnin edhe bishtra dhe përhapeshin fjalë se ai i përkrahte të varfërit, i dhimseshin bujqit e këtushëm. Dhe sapo që kthyer që andej, kish nisur të mendonte thellë... Që kishte shkollë, dukej e të mbushej mendja se mbante syza nga ato që mbajnë ata që lexojnë shumë e që janë të ditur e të urtë!.. Edhe që njerka s'e donte ishte marrë vesh.

«Vetëm një gjë nuk marrim vesh,» thoshin bujqit, «pse ky Isai i Xhezos rri brenda në konak e dërdëllit që nga dysheku?!»

Edhe kur mbaroi lufta dhe vendi u çlirua, Isai rrinte më shumë brenda se jashtë. Thoshin se kish kiametin me libra nga ato të trashat me kapak të fortë dhe lexonte pa reshtur. Lexonte e shkruante. Këtë punë bënte.

«Do jetë ndonjë kokë qy!... Po, po, sa që merret me libra e nuk del nga dera, kokë duhet të ketë se, që të dalësh përjashta, lipsen këmbë!.. Apo jo?» thoshin njerëzia.

Xhezua u përzie me marifet me fshatarët.

Ai fliste për të drejtën, që zbriti nga malet dhe për varfërinë, që u shporr; dhe mundohej të futej sa më thellë në gëzimin e bujqve, që mbanin takijen mënjanë. Dhe bujqit, që mezi panë ditë të bardhë, s'donin të mendonin për asgjë të keqe! Vajtën ato... I mori lumi të tuat, të miat e të tërë fshatit, o, Uan Kërri! Ikën... Vanë... Lërinë...

Isai nxirrte nga konaku fjalë.

— Ai Isai, ore? Ai i veremosuri s'na pëlqeka reformën?...

— Po, po, i veremosur. I qafsh hallin atij. Ha nga një gjysmë kile mjaltë Kanine për mën-gjez ai, prandaj e ka çehren të verdhë...

— Unë e ti hamë nga një gjysmë koromane me dhallë dhe jemi më mirë.

— E, ashtu, xhanëm, se mjalti të djeg përbrenda, ore... Atë djegje duhet ta shfresh, ta nxjerrësh...

— Edhe ai përbrenda përvëlohet, gjersa rri ditë e natë në dyshek e dërdëllit...

— E, po, fundja na plasi ne, se lehka një lingua...

Kështu flisnin bujqit për Xhezon e për Isanë ato kohë. Gjersa një ditë të kthjellët janari, në fshat u vërvit lajmi se në shtëpinë e verdhë qenë strehuar diversantët. Ata, që atë natë të errët dimri, kishin vrarë katër komunistë të fshatit, tek ktheheshin nga mbledhja.

Atëhere bujqit u përmendën.

Xhezon e pushkatuan, por Isai mbeti gjallë për të llomotitur poshtë e përpjetë fushës.



— A, sa i di ajo kokë! Nuk qe përzier me diversantët i paudhi!... Pa do ta kish ngrënë...

#### IV

Me të hyrë në territorin ushtarak, nisi përsëri një këngë. Këtë radhë ishte një këngë partizane, që Todit i pëlqente pa masë, por që ai s'mernte guximin ta këndonte edhe vetë, se mos e prishte.

Djersa e stërvitjes sapo qe terur. Mbi uniformë shquanin vurrata të përhimta, si pëllgje të shterura ndanë gjoleve të kripura. Nën pajime buronte djersë. Armët dhe helmetat, që lëshonin nga një xixë shkëlqimi, mbanin një cipë pluhuri të verdhë.

Këmbët brenda në këpucë notonin në djersë, por hapi ishte i rëndë e i ngjeshur.

Todi mbante në sup mitralozin e skuadrës. Peshën e ndjente që nga shpatullat, që i vareshin, e gjer te tabanët e këmbëve, që i përcëllonin. Me opinga e sandale u kishte rënë arave cep më cep, po këmbët s'i kish ndjerë kështu. Djersët i rridhnin nga koka, nëpër fytyrë dhe ai s'kish dëshirë t'i fshinte.

Pas drekës toga i kishte bërë veprimet fët e fët, ndonëse kujt do i shfaqej sheshit një farë plogështie. Pastaj ushtarët kishin rënë në pushim. Dukej sikur për shumë kohë ata nuk do ta përmblydhnin dot veten, pas asaj stërvitjeje, që kish nisur me natë. Edhe Todi e ndjeu veten të dërmuar kur u shtri në krevat. Pështja e mitralozit i qëndronte akoma mbi shpatulla dhe, ashtu sy-

mbyllur, nëpër një gjumë të shqetësuar, toka i rrëshqiste nën këmbët e tij. S'kish të sosur ajo rrëshqitje, ajo ecje e pafund me komandë ushtarake: doemos duheshin mësuar të gjitha shtigjet, duhej kaluar nëpër to në errësi, në pisk të vapës e në acar, me zvarritje, këmbadoras, me vrap...

Ushtari hapi sytë. Fjetina e heshtur dihaste. Ai u kthye në anën tjetër, në krevatin e sipërm dhe sytë iu mbyllën prapë nën qepallat e rënduara... Vegimi i të katër horizonteve zë i shfaqet në ëndërritje dhe ai i shikon ato nëpër mes thepit dhe shqekëzës. Merr frymë thellë dhe, nën gjoksin e tij ushtarak, fërkohet gjiri i tokës së majme; afshi dhe aromat e saj i gudulisin flegrat, e çojnë gjer në arat e kooperativës. Duke u tërhequr zvarrë, rëmon dheun dhe hap vend si për të hedhur farë... farë ushtarake, që lëshon rrënjë e bisqe kudo në këtë tokë...

Atë ditë Todi kuptoi se, veç stërvitjeve brenda territorit ushtarak dhe atyre nëpër terrenin e hapur, që ishin mjaft të lodhshme, kishte edhe detyra të tjera, që as do t'i shkonin në mend kohë më parë.

Duke u kthyer nga fusha taktike, mu në mes të udhës përpara togës dolën dy fëmijë, që nga të rendurit e nga vapa ishin përskuqur në fytyrë e kullonin djersë. Rrëfenin ca të trembur e të tronditur sa që mezi nxirrnin fjalë nga goja e shkrumbuar. Dukej sheshit se një rrezik i papritur i kishte prurë në këtë gjendje.

Toga vetvetiu ishte ndalur në vend.

— Ushtarë!.. O, ushtarë!.. Atje... në shtë-



pinë e... Zebos ka... ka zjarr... Digjet... —  
mezi mundën të thoshin fëmijët.

Një vrapim të tillë, me tërë pajimet mbi kurriz, ushtarët s'kishin për ta harruar kurrë. Asqë vërenin për rrugë. E gjithë toka që hedhur në një vërshim të rrëmbyer, drejt fshatit aty pranë, nga ku ngrihej një tym i errët, që thuajse po gllabëronte gjithshka përreth si një vorbull e zezë dhe kërcënonjëse në qiellin e kaltër.

Një nga fëmijët nuk u ndahej ushtarëve dhe qante me dënësë. Qante dhe thoshte pareshtur: «Brenda është nënëgjyshja me motrën». Mirëpo asnjëri nuk ja vinte veshin. Asnjëri nuk kishte nge të merrej me gjësendi tjetër, veç atij vrapimi të shfrenuar. Oh, ç'vrapim u bëka edhe me këpucët ushtarake, që në fillim të duken aq të rënda!

— Kundragazet!.. — u dëgjua një komandë.

Tymi kishte mbushur të gjithë dhomat; sendet dhe muret qenë zhdukur. Ushtarët çapiteshin me hamendje, ndodhte që përplaseshin me njëri-tjetrin dhe mezi i bënëin udhë shoku-shokut.

«Djali e mori» tha me vete Todi.

Ai doli në sallonin e vogël dhe bëri mënjanë pjesën e llastiktë të kondragazit, që i mbulonte veshët. Dëgjoi me kujdes. Tymi iu vërsul drejt e në hundë dhe i zuri firomën. Sytë i dogjën dhe sakaq i dualën lot. Tamam atë çast që prapa kurrizit dëgjoi një kollitje të pafuqi, si e teshtira e maces. Lëshoi pjesën e llastiktë në fytyrë dhe ajo iu puthit. Shfryu për të nxjerrë tymin. Këmbadoras zuri të kërkonte anës së mureve, duke përgjuar lëvizjen më të vogël.

Pas një çasti, në oborr doli një ushtar me vajzën e vogël para duarve, i mbështjellë nga tymi, që dukej sikur e ndiqte pas. Lëkundej dhe mezi hidhte këmbët. Ata që prisnin u sulën drejt tij, muarën fëmijën dhe e çliruan ushtarin, duke i hequr helmetën dhe maskën.

Todi nuk lëvizte nga vendi. Edhe duart i kishin ngelur ashtu siç mbante fëmijën. Shtrëngoi dhëmbët dhe mblodhi tërë fuqitë. Një marrjemendsh e turbullonte pa masë. Ndonëse pa kundragaz, ai një copë herë të gjatë nuk mund t'i mbushte mushkëritë me ajrin e pastër. Mbi gjithë këto, në shpirt e mundonte ajo qënje delikate dhe e mjerë, që varej në krahët e tij si një lastar i këputur e pa jetë. Atë ndjenjë të dhimbshme nuk e pati provuar kurrë, gjer atë çast, dhe me siguri s'kish për ta harruar ndonjëherë.

Ndërkaq nga brenda nxorën edhe nënëgjyshen.

Toga që rreshtuar dhe nisi udhën për në territorin ushtarak.

Fshatarët, që po ktheheshin nga arat, merreshin me të dëmtuarit: me vajzën dhe nënëgjyshen e saj. Ajo fëmija vazhdonte të qante.

Vetëm pas disa ditësh, në komandën e njësisë, do të shkonte një letërfalënderimi për një togë ushtarësh, dhe një... «ushtar, që fatkeqësisht nuk ja mësuam emrin». Me siguri ata rreshta, me një shkrim të kujdesshëm, kishin për të habitur shefat dhe eprorët, që s'dinin gjë. Në raportimet ushtarake mbi të rejat e ditës, këto ngjarje nuk hyjnë. Rregullorja nuk ka ndonjë paragraf të tillë.

Dhe sigurisht për këto ngjarje, ushtari kishte



të drejtë t'u shkruante nëpër letra të afërmve të tij; t'ua numëronte fill e për pe nënës, motrës, Lirës. Veç se për atë që e brente përbrenda një si dridhmë e pakuptuar nuk mund të vinte në letër qoftë edhe një llaf të vetëm.

Sapo që dilte nëpër territorin ushtarak dhe shikonte xhiroskopin e çuditshëm, atë trupin e madh të aeroplanit-model, të varur në ca litarë të trashë çeliku, pa e kuptuar, i qasej dëshpërimi tinzar dhe e pushtonte të tërin. Dhe sakaq jeta merrte përpjestime të ngushta: mbyllej brenda territorit dhe brenda kufive të ndjenjave ashtu si në ditët e para.

Todi dëshironte t'i jepte fund një orë e më parë asaj stërvitjeje, që e mundonte pa mëshirë, për të cilën bëhej fjalë dendur. Bile, me sa kuptonte ai, tek e fundit çdo gjë bëhej për atë stërvitje...

Ushtarët e vjetër futeshin në xhiroskop pa të keq. Ata rrotulloheshin me shpejtësi në të katër drejtimet, saqë trupi i tyre merrte forma të çrregullta, të habitshme. Kur dilnin që andej, ata qëndronin drejt më këmbë e pa lëkundje më në fund kërcenin nga trampolini përposh butë-butë, me këmbë të bashkuara e gjunjët pak të thyer.

Lirimi, që e bënte me shkathtësi këtë punë, e përsëriste kushedi sa herë, duke vlejtur kështu si model për të rinjtë.

— Ky është si mace — ja bënin disa me të qeshur.

Ushtarët e rinj shfaqnin vullnet të fortë, me atë vendosmërinë e tyre, për tu përgatitur sa më mirë.

Komandanti, një burrë me moshë të thyer, që s'ta mbushte mendjen të qe hedhur disa qindra herë me parashutë, bënte vërejtje e thërriste me zë të lartë:

— Ku shkon me ato këmbë të hapura? Toka nuk është pambuk... Mu si thes ke rënë... Prapsoku! Edhe një herë përsërite. Të merren mendtë?...

Tek rrinte për t'u çlodhur një copë herë, Todi mendonte dhe humbiste durimin.

«Do ishte mirë t'ua thosha troç: nuk e bëj dot». Dhe dëshpërimi, që e kishte kapur, dita-ditës i shtohet pa u ndjerë, tinëz.

— Mos t'ju vijë çudi. Të gjithëve kështu na është dukur gjë e pamundur. Kjo vjen nga që hedhja me parashutë nuk është si ajo e marinarit, që e nis kërcimin nga trampolini pak e nga pak, gjersa arrin disa dhjetëra metra...

Kështu u kishte thënë komandanti i rreptë, që ishte shkëputur qindra herë nga aeroplani. Dhe, siç bëhet përherë, edhe atë ditë stërvitjen e mbylli me këto fjalë:

— Mos t'ju vijë çudi. Këtu në tokë ne bëjmë një pregatitje që i përngjet së vërtetës. Ajo e vërteta, kur këputesh nga njëmijë e ca metra më të poshtë, drejt tokës, është tjetër soj... Është vepër e një guximi të rrufeshëm...

Todit i dukej se këto fjalë i drejtoheshin vetëm atij.

«E kujt tjetër veç meje, kujt?»

Ai e shikonte se po binte në sy për keq në stërvitje, aq sa komandanti seç i drejtonte ca shikime, që i ngjallnin dyshim. Komandanti, sipas Todit, kishte shumë të drejtë. Ç'i duheshin atij



llafet e mira, që thuheshin në togë për ushtarin Todi Pisha, që paskësh shpëtuar një fëmijë nga vdekja e sigurt, që ishte mitralier i mirë, i palodhur në marshime e punë... Ushtarë të tillë kish plot, po që të hidheshin me parashutë... ë, hë!..

Kishte nisur të mos e bënte gjumin njësoj. Flinte dy-tri orë e zgjohej. Prapë flinte e prapë hapte qepallat e rënduara, prej nga rektinte një rreze e mekur drite.

Lira ishte larg, shumë larg. Sikur ta kishte pranë, ndoshta do t'i thoshte një fjalë për të qenë. Vështrimi i saj i gjelbër, që nuk i përngjante aspak vështrimit hetues të komandantit parashutist, ndoshta për një çast do t'i jepte zemër ta kuptonte atë rrymë dridhme.

Nëna e butë, e dhimsur e shpirtgjerë, nuk do t'ja hidhte sytë, për të parë se çfarë e mundonte të birin. Ajo e kish bërë zakon të vështronte mënjanë, kur fjalosej me Todin, me djalin e saj të vetëm. Ajo fliste më shumë për të kaluarën, kur shikonte se djalin diçka e mundonte. Por, sido që të ishte, sa mirë do të qe sikur t'i gjendej pranë!

«Hap sytë, biro. Të na nderosh!..»

Xha Uani, i mplakur, i heshtur, do t'i fliste më shumë se kushdo, me ato tre çerek shekulli jetë nëpër baltën e Myzeqesë, që mbante mbi shpatulla... Me tre djemtë e hedhur në erë nga mina e dambllotur gjermane; me tre çupat, që dukej se e hiqnin përdore arave të kooperativës...

Edhe lapidari me emrat e dëshmorëve të fshatit shumë kishte për t'i rrëfyer me bardhësinë e tij.

Po pse, Isa i Xhezos?...

Todi, pasi çeli sytë për të katërtën herë gjatë asaj nate të shqetësuar, u çua përgjysmë në krevat, i mbështetur në bërryle. Hoqi mënjanë batanien, u var poshtë me kujdes e pa zhurmë dhe iu qas Lirimit. E zgjoi atë, duke i fërkuar në gjoks pëllëmbën e tij të rëndë. Por nuk shqoi dot habinë, që u shfaq atë kohë në sytë e shokut.

«Ah, ta dinit ju!...» mendoi, «ah, ta dinit se ç'po heq...»

E mori shokun për krahu, duke i bërë she-një për të dalë jashtë, dhe u shtir përpara rojes sikur kishte dhimbje barku. Roja, i shtyrë nga detyra që kryente dhe nga kureshtja, vuri re se të dy ushtarët, gjysmë të zhveshur, muarën për nga veglat e ushtrimeve të vështira. Xhioskopi zuri të gumëzhinte.

Atë natë, ndaj të gdhirë, e fshehta e Todit, e përzier me atë dridhmë shqetësimi, zuri vend në sytë e çiltër të Lirimit. Ajo u nda më dysh, u copëtua, që pastaj të humbiste pa nishan, aty nëpër territorin ushtarak, ku kish nisur të shfaqej.

## V

— Letra për ushtarët! — thërriste si për herë, edhe atë ditë postieri.

Dhe ata u mblodhën shpejt rrotull tij, shtrëngoheshin njëri pas tjetrit. Shtyheshin. Zgjatnin kokën për të parë duke thënë «Po unë? Po unë?...» Kjo pyetje përsëritej ma reshtur, gjersa letrat sikur



i mori era dhe përçark postierit ushtarak mbetën vetëm nja tre a katër ushtarë, që u larguan duarbosh dhe u bashkuan me të tjerët. Edhe ata donin të dëgjonin ndonjë llaf për Azotikun, për Vaun e Dejës, për kooperativën, për fshatin. Se letra për ushtarin është njësoj si gazeta. Ata do të dëshironin të lexonin përditë letra, siç lexojnë edhe gazetën. Dhe ishin mbledhur kokë më kokë e lexonin nga tre e nga katër.

«Letra për ushtarët!..» këtë thirrje të gëzueshme, që u përhap atë pasdite nëpër territorin ushtarak, Todi e përsëriti me mendje disa herë. Dhe mendja i bridhte nëpër letrat që i kishin dërguar nëna, Lira dhe Gora. O, sa shumë letra! Lloj-lloj letra: me kuti, me vijëza bukurshkrimi, ngandonjëherë edhe pa kurrfarë vijash, me lloj-lloj gërma e fjalë, nëpër të cilat shfaqej lapidari, atje në mes të sheshit me emrat e dëshmorëve të fshatit, dhe përçark godinat e kryesisë, vatra e kulturës, shtëpitë, arat e kafenjta e tërë vlag. Nëpër ato rreshta ecte vijë më vijë nëna, që çapitej brazdë më brazdë ugareve; nëpër ato rreshta, që dendur shtrembëroheshin në fund të letrës, rrëshqiste vrullshëm maqina e kooperativës, që sulesh rrugëve të fushës, duke marrë pas një bisht pluhuri; nëpër ato rreshta dilte xha Uani, që trokëllinte shkopin në derën e «Gazit» dhe pyeste: «Ku do ta çosh pambukun, moj Lirë?» Dhe i jepte porosinë e brigadierit, që të kthehej në Azotik e të merrte atë plehun e bardhë si kripë.

Nuk mbetej pa nxjerrë kokë, në ato letra, edhe Isai me shtëpinë e verdhë, që dashkej të largohej nga fshati, se nuk paskej krahë pune»...

Isait mënd i ranë syzet përdhe, kur lexoi fletërrufenë tonë për prapësitë që ka bërë, sidomos gjatë fushatës kundër fesë e mbeturinave» i shkruante Lira dhe më pas, nëpër vijëzat e jeshilta, çapiteshin viçat larushë me hundëza druri, që kullosnin me orar jonxhave, rrëzë pyllit të moçëm me pishë.

Kohët e fundit nëpër letra zuri të shfaqej edhe kënetat si një vurratë e ndotur, që sa vinte përthahesh, si një abses që po e thëthinin me ca shiringa gjigante që i zbrasin në det.

«Ja kam frikën Lirës, biro, se mos m'i bën gjë ai i fantaksuri, Isai... I fola, po s'më dëgjoj... I vete kundra atij dhe nja dy brigadierëve...» i shkruante nëna.

Dhe Todi, ndonëse ndjente mbi shpatulla pajimet ushtarake, gëzohej e shqetësohej njësoj, sikur të ishte në fshat. Njësoj sikur të qe bujk. Duart me kallo i mbani erë pleh, nga patatet e posambjella në ekonominë ushtarake. Nëpër këpucë kish baltë ugaresh, që i kish llangosur shojet. Veçse këto këpucë nuk lihen te praku pa u llustruar mirë.

Todi merrte dendur letra nga fshati. Të shumtat, afërmendsh, i vinin nga Lira, që, siç mendonte ai, e kishte më lehtë t'i hidhte në kutinë e postës së qytetit. Ajo shkonte dy herë në ditë me maqinë në qytet.

Si përhera, edhe këtë radhë ajo i kishte mbushur të katra faqet e ngjitura të një fletoreje me kuti. I shkruante për të tëra punët e kooperativës, për lapidarin që e kishin lyer sërishmi, për të korrat, për viçat, për maqinën, së cilës i kishin vënë goma të reja, për nënën dhe Uanin, Gorën,



që dukej sheshit se dashurohej me mësuesin, me atë nga Fieri.

Pastaj Lira vazhdonte për një fletërrufe, që rinia i kishte qindisur priftit dhe që atëhere ai e kish parë piskë, kish hequr rason, kish rruar mjekrën dhe kish hyrë në kooperativë. Ishte bërë përgjegjës i stallës së derrave. «E di sa mirë punon! Por i bënë përsëri një tjetër, se nuk donte që shënmëria të bëhej kinema dhe fliste poshtë e lart.

«Le të rrinë muret siç janë... S'na bëjnë asgjë ikonat... Pse ta bëjmë kambanën çangë?...» Dhe mbante edhe kreshmë. Po tashti është ujdipur. Edhe lëkura i është nxirë ca nga dielli. Kur ishte prift, ti e mban mend, nuk qeshte kurrë. Tashti qeshet e çirret më keq se çobani.

«Më bëhet qejfi kur dëgjoj emrin — thotë. — Se ajo uratë, uratë, uratë, m'u bë si një vurratë e zezë në lule të ballit... Dhe të tëra këto më ngjan se më erdhën nga mentë e asaj Lirës së Uanit. Kur e pagëzova, ja lashë kokën thatë asaj pipiricke...» Kështu kam dëgjuar se thotë papu, por nuk di në e ka me tërë mend». — Këto i shkruante Lira ndër të tjerat.

Todi qeshte me vete, kur lexonte.

Më tej Lira shkruante se muajin që kish shkuar qe marrë më shumë me ngritjen e banjave. Organizata e partisë dhe kryesia e kishin ndihmuar mjaft inisiativën e rinisë. |

«... E di ku e kemi ngritur banjën? Mu aty te zyrat e kryesisë. Kemi zgjedhur një vend shtroerë. Si ndërtesë, e kam fjalën si bina, nuk

është kushedi çfarë. Është si një farë kazerme e gjatë, e ngushtë, mbuluar me eternit. Ti e merr me mend. Por ti nuk përfytyron dot që tamam godina e ulët, ca e fshehur, dhe jo e fshehur nga turpi, po nga era, është bërë sikur të qe ngritur një pallat shumëkatësh, me veranda e shumë shka llë. S'di si të të them. Nuk mbetet njeri pa kthyer kokën për ta parë. Të gjithë mezi presin sa të hyjnë brenda. Ti, Todi, e merr me mend, më shumë harbojnë të rinjtë. Ka edhe nga të moshuarit. Ka, posi. Po ka edhe nga ata që, kur këthejnë kokën nga kjo godinë e ngritur me nxitim, çakarritin sytë dhe thartojnë buzët, sikur të shikonin ndonjë trup lakuriq. Dhe kështu edhe flasin poshtë e përpjetë fushës. Shumë fjalë, ti e merr me mend, dalin nga shtëpia e verdhë, po me marifet... Isai më ngjan se po kurdis edhe këtë herë diçka. Po atë s'e dëgjon njeri. S'do as ta shohë njeri. Atë as njerka s'e do. E ka zbuar çosa herë nga shtëpia. Ai ta shpif kur të del përpara. Dhe endet fushës dhe rrugëve, ku ta çojnë këmbët. Sido që të jetë, mos kujto se ka hequr dorë... Mua më ngjan se diçka po kurdis... E, po ma dhe punë!...

«Pardje, të shtunën, na shkrepri për të provuar dushet. Dhe u zveshëm që të pesa, unë, Gora, Mala, Vita, Naunka dhe u futëm. U lamë e s'na bëhej të iknim. Mbetëm të ngashëryera dhe shikonim njëra-tjetrën në sy. Ç'kishim bërë ne? Kishim bërë ndonjë turp? Ne kemi vendosur që sivjet të prishim edhe zakonin fetar të larjes së këmbëve e të duarve në det: të larjes së gjyna-



heve! Ne do të organizojmë gara noti më pesëmbëdhjetë gusht «ditën e larjes së gjynaheve».

«Kështu, ne u lamë të parat në dushet që ngritëm vetë dhe ndjemë një dehje të vërtetë.

Kur hodha këmishën në trup dhe veshja pantallonat, më hipi në kokë t'i hiqja prapë rrobat. Këtë ua thashë edhe të tjerave. Dhe të pesa ja dhamë të qeshurit mu atje brenda. U zveshëm prapë. Ujë kishte sa për pesëdhjetë. Ne qemë pesë. Dhjetë herë mund të bënim këtë punë. Banja ishte gati!

«Po jashtë saj, ta dish se ç'llafe u thanë! Kjo na shkoi në mend, kur hodhëm sytë nga dritarja me xhame të avulluar.

«S'ja kemi ngenë asaj, jo, — thoshin bujqit. — Ç'ti ruhem i dheut dhe baltës!... Ky dhé e kjo baltë na ushqen e do na hajë...»

«Isai mban vesh. Merr ato që i duhen dhe kurdis të tjera...»

«Kemi vendosur që gratë të hyjnë të parat në banjë».

Në fund, Lira i numëronte të falat e shumta që i dërgonin nga fshati dhe i jepte Todit përqa-fimin e saj.

Ushtari jetonte një copë herë të gjatë me jetën e atyre njerëzve, që i dërgonin për së largu gëzimet dhe shqetësimet e tyre. Sigurisht, ai sillte në mend edhe leshrat e verdha e të prera si hamullore plot aromë!...

Ditët rrokulliseshin të zakonshme. Ato iknin çuditërisht shpejt për ushtarin. Todi nuk donte që ato të përsëriteshin, por ja kish ënda të qenë më të ngadalta. Ai po soste në muajin e shtatë të shërbimit dhe vetëm pas disa ditësh kishte për të dhënë provën e parë në ushtri. Një provë me të vërtetë të vështirë. Këto mendonte ushtari tek dëgjonte për ditë këshillat e bisedat moralizojnëse të komandantit. Ato ishin të vërteta, ndaj edhe të ashpra. Secili nga ushtarët në ato çaste e ndjente veten me guxim të pamjaftueshëm. Vetëveten e tyre e trazonin ndjenja dhe mendime nga më të ndryshmet, mendime që u lidheshin me atë kërcim të çuditshëm, me të cilin po jetonin prej kohësh.

— Kam njohur një njeri — u thosh komandanti. — Ishte një trim me fletë këtu në tokë. Por mezi u bë guximtar i qiellit... Edhe një aviator, tek stërvitej për hedhje me parashutë, nuk e përmbajti dot emocionin e pritjes. U hodh pa sinjal dhe ra, për faqe të zezë, mu në stacionin e trenit, tromaksi dynjanë... Kur vanë ta merrnin, ai po bënte një bisedë entuziaste me udhëtarët e geshëm...

Komandanti me siguri i kish njohur këta njerëz. Veç kësaj, nuk e kishte për zakon të krijonte gjë prej gjëje. Për atë, rëndësi të posaçme merrte ndër ato ditë rregullorja. Ai ishte i vjetër dhe qe hedhur qindra herë. Dikur u pati folur ushtarëve edhe për një hedhje të tijën, jo shumë të lumtur, që për pak sa nuk i kushtoi



shtrenjtë. Kupola e parashutës i kishte ngeiur në një degë peme të lartë. Po të zgjidhej nga rripat e të kërcente poshtë, me siguri do thyente ndonjë nga gjymtyrët, në mos edhe kokën... Dhe ai mezi u ngjitur nëpër litarë për të zbritur pastaj nga pema e madhe.

Shenja e një plage të vjetër, nën mjekër, tregonte vetë se ai dikur ishte ndeshur me diçka, që i kishte lënë gjurmë...

Kështu rrëfente raste dendur e më dendur komandanti, ai njeri i ashpër e i prerë, që i binte çdo gjëje drejt e drejtë, «me sëpatë», siç thosh vetë komisari.

Ky, nga ana e tij, kishte kërcyer vetëm tri herë nga aeroplani në hapësirë. Por i vinte ndoresh ta rrëfente hedhjen aq bukur e me ndjenjë sa të bënte për vete. Hollësitë qenë të shumta, që nga çasti i shkëputjes, gjer në rënjen në tokë. Ushtarët, që kishin provuar hedhjen e parë, ja bënin: «Tamam! Sa mirë e tha! Pikë për pikë!» Ndërsa të rinjtë gojëhapur gëlltitnin fjalët e komisarit dhe merrnin zemër sikur ato qenkeshin gjithshka u kërkonte zemra.

«E provuam se ç'qe edhe kjo punë...» mendonin ata.

Komisari, gjatë bisedës, në të njëjtën kohë, i jepte të drejtë sikujt nga ushtarët e vjetër të shprehte mendimin e tij. Këtë, natyrisht, e bënte i shtyrë nga dëshirat e të rinjve, dëshira të cilat pak kohë më parë i kishte ndjerë vetë.

Ai kish pasur gjithnjë prirje për rrëfime të rrjedhshme, madje hartimet e tij çmoheshin si më të goditurat, në gjithë klasën, ndoshta edhe

në gjithë shkollën «Skënderbej». Dhe shpesh mendonte se dikur duhej t'i hidhte në letër kujtimet e tij e të ushtarëve.

— Desanti ajror, — thoshte ai, — i zbret kundërshtarit mu në vatër dhe e gjen këmbëzbatthur... Desanti është gjuha e zgjidhur e armikut, në ndihmë të shtabeve tona...

Todi, në këto çaste, jetonte me të tëra ndjesitë me detyrën e vështirë që po afronte. Dhe bënte përpjekje që të çonte në vend ato që i patën kaluar të çala e gjysmake, në përgatitjen e ditëve të para. Dukej se çdo gjë po zinte vendin e saj, ashtu sikundër lumenjtë zënë rrjedhën e tyre, pas vërshimeve të vrullshme. Por dihet se vërshimet janë të papritura dhe lumenjtë jo rrallë i përballojnë ato.

Atë pasdite të qetë e të vagët, me ca re të përndara si tym i përhimtë, ushtarët po kalonin orët e kohës së lirë, sikush sipas dëshirës.

Në lulishten përpara dhomës kulturele, Todi po dëgjonte buzëgaz Lirim.

— ... Unë jam peshë e lehtë dhe më mori ca era e më ndau nga shokët. Shikoj poshtë dhe se, po i afrohesha një majë kodre. Aty kishte ca qiparise të gjata. Mu në buzë të kodrës dredhonte një xhade. Ajo ishte e shkretë, pa asnjë lëvizje. Të them të drejtën, më hyri frika; po sikur të bija mbi qiparise? Mirëpo isha aq ulët, saqë nuk arrita të mendoja ç'duhej bërë, kur u plasa përdhe. Këtu ndodhi një çudi: kupola e parashutës ra ngadalë dhe mbuloi një plakë e një vajzë të re, që, me sa dukej, po çlodheshin nën hijen e qipariseve. Unë nxitova t'a mbledh kupolën, duke e tërhequr nga litarët, por sakaq ato u ngritën të mbuluara nga



mëndafshi i kupolës dhe u ngatërruan keqas. U desh një kohë sa i zbulova. Plaka më vështronte me ca sy të shqyer dhe ja bënte: «Virgjëreshë e shenjtë, na ruaj!» Buzët e rreshkura i dridheshin. Me nxitim bënte kryq. Ajo shikonte me zemërim vajzën e re, që gajasej së qeshuri dhe po atë vështrim ma hidhte dhe mua.

Në fillim më erdhi keq për atë njeri të tronditur aq shumë. Kjo më shikonte ashpër. Tërë rru-dhat e fytyrës i dridheshin, edhe sytë e futur thellë i lëvrinin. Kushedi ç'e shtynte atë plakë të arrinte në atë gjendje. Ndoshta qe trembur nga zbritja ime e papritur, ndoshta pandehte se kisha bërë gjynah të madh, që kisha zbritur nga qielli... Ku ta dish se ç'mendonte ajo plakë.

Unë mblodha parashutën, e futa në vendin e saj ashtu dosido, e ngrita në sup dhe bëra një hap. Gjuri i djathtë më theri. Kisha rënë keq në tokë. U ula të merrja veten. Ajo vajza nuk qe larguar nga vendi dhe më shikonte me habi. Kur unë buzëqesha kot dhe i bëra shenjë të vinte të ulesh, ajo fshehu fytyrën me leshrat e gjata; pastaj iku, ndoshta për të kërkuar plakën e rreptë besimtare, që ishte larguar si një hije duke mër-mëritur.

Ajo çupa sikur ma prishi ca terezinë se, siç e dini, në jetën ushtarake, takimi me një vajzë është gjë e rrallë. Për shumë kohë s'më hiqej nga mendja të qeshurit e saj... Edhe dhimbja e gjurit më shqetësoi ca ditë...

Todi dëgjoi me kureshtje, ndonëse pak u fol për atë që i donte zemra. Pak tregoi Lirimi për fluturimin, për pregatitjen, për atë pritjen e çastit të hedhjes, që me sa dukej, qe më i vështirë.

«E bëri me qëllim ky» mendoi Todi. «Se edhe dy ditë ngelën...»

— Ka ca gjëra që nuk të hiqen nga mendja... — ja bëri Lirimi, sikur po zinte fillin e një kujtimi tjetër.

— Është një damar i fshehtë, që bën këtë punë, — ndërhyri e tha Aliu, që dukej shumë i mërzitur.

Të gjithë sa qenë aty, ja dhanë të qeshurit.

— Kështu thonë, sikur është një damar...

Ushtar Aliu kishte ndryshuar shumë gjatë atyre ditëve. Nuk dihej sepse akoma, por nga goja e tij s'po dëgjoheshin më ato fjalët: «Po të marr patentën, i them tungjatjeta fshatit. Ja, kjo më duhet mua, s'më duhen zanate të tjera...» Në këto raste shfaqej haptazi qëllimi i tij në jetë. Dhe kur shokët, bile edhe komisari, e kundërshtonin, ai ja bënte:

— Unë jam rritur në qytet, te xhaxhai, — dhe shtonte jo pa qëllim: — xhaxhanë e kam në degën e brendshme...

Ali Kërçelli vinte nga një fshat malor, ku, siç thoshte ai vetë, edhe shtëpitë qenë pjesë të shkëmbinjve. Me ato pak ara që kishin fshatarët, u duhej të robtoheshin pas vijës së ujit, se përndryshe nuk arrinin të merrnin asnjë kokërr beqet. Për kooperativë as që bëhej fjalë. E si mund t'i bashkoje ato ngastra të shpërndara si fletë dushku të flakura nga era? Atje vetëm dhi mund të mbaje dhe ndonjë mushkë a gomar për ngarkesë.

Një fshatar, një farë Nexhipi, siç tregonte Aliu, e kishin bërë të çmendur se donte të mbante lopë. Dhe kur ai ra e vdiq papritur, disa pleq patën thënë: «E zuri beduvaja. Mori më qafë



gjënë e gjallë... Ja si e pësoi...» Një lopë i qe rrëzuar e kish thyer dy këmbët e para, ndërsa tjetra ish gremisur në rrëpirë e nuk iu gjend ni-shani. Që asokohe këtë punë nuk mendoi ta bënte njeri, se edhe hoxha e pati mallëkuar.

Aliu të gjitha këto i rrëfente me seriozitet dhe s'donte t'ja dinte nëse ushtarët, ndërkohë që dëgjonin, shkriheshin së qeshuri dhe ja bënin:

— Gjepura!

— E, ashtu thoni ju, se s'kini parë një vend si ai. Kini hakë të qeshni — fliste Aliu me ngut, duke shpresuar që t'u mbushte mendjen të tjerëve, që më në fund ta mëshironin.

Më pas ai kishte mundur t'i prekte në shpirt shokët. Fytyrat e tyre, ndonëse fare të njoma, që s'dinin ç'është vrazhdësia, qenë mbushur me pikëllim e me urrejtje të madhe.

Ushtarët mësuan se aty para tre vjetësh, në fshatin malor Guraz, një vajzë katërmëdhjetë vjeçe, e imët në fytyrë dhe e pakët në shtat, ishte shpallur «shpirt i mallëkuar».

Ja si kishte ngjarë.

Ajo sapo kish futur në gji dëftesën dhe, duke shkuar për në shtëpi, i bëhej sikur dëgjon-te pareshtur fjalët e mësuesit:

«Tashti i kini dyert të hapura për në çdo shkollë: të bëhi infermiere dhe doktoresha, agrome, mësuese... Ç'të dëshëroni...»

Rrugës, ndërsa i afrohej shtëpisë, zuri të ndjente mallëngjim, që ish ndarë nga shkolla, nga mësuesi aq i mirë, nga shoqet, nga shokët. I dhimbseshin aty edhe bankat, edhe dërrasa e zezë, ku ajo për herë të parë shkrojti gërmën «a», më pas fjalët «Parti! Enver!» Dhe mbetej e shas-

tisur tek shikonte buzëqeshjen e mësuesit, atje pranë dritares plot dritë.

«Ti shkruan bukur, Rufe... Pa lexoji këto dy fjalë!...»

Vajza kthehej nga klasa dhe thoshte me një zë, që as vetë s'e kuptonte se ku mund t'i qe fshehur në atë trup të pakët:

«Parti!», «Enver!»

Klasa, e mbushur plot dritë malesh, buçiste. Vajzës i kumbonin veshët dhe ato fjalë, që vërtiteshin nëpër dhomën e mbyllur, sikur ktheheshin prapë, për të zënë sërishmi vendin e tyre në atë gjoks të vogël.

«Mirë, Rufe! Shumë mirë! Pa lexoje me rrokje, lexoje...»

Nga që e kishte shpënë mendjen te këto, vajza kishte zënë të përlotej. Merrte frymë me mundim, thujse malet po i rëndonin në shpirt. Mirëpo malet i dukeshin të urta e të dhimsura, madje edhe pse qenë sende pa shpirt e pa gojë, që s'mund t'ja përzinin atë brengë, që kish marrë me vete sa e sa të reja.

Rufeja nuk qe e para në fshat, që kishte etje për dije. Ajo e dinte këtë fare mirë edhe nga të katër motrat e saj, që kishin mbaruar filloren dhe ishin mbyllur në konak.

«Ç'u lipsej të tjerëve se ç'bën filani... sikush shikon arën e vet dhe prakun e vet...» Dhe kështu, çdo shtëpi, që mbyllte brenda mureve të akullt njerëz, kishte një «zot», ashtu siç kishte edhe çdo arë zotin e saj.

Babai qe njeri i vrazhdë e i rreptë, fetar i madh.

«Sa të jem gjallë e sa të dëgjohet emri im,



kështu do jetë. Mos më fëlliqni! Mos më bëni me turp! Do ju shuaj!» Hungëronte ai nëpër konak.

Vajza e dinte mirë se ai urdhër i pashkruar i hoxhës, që çupat e fshatit të mos shkonin në qytet për shkollë, kishte hedhur rrënjë edhe tek i ati, në shtëpinë e saj.

Ashtu e përlotur, u ndal te praku i shtëpisë, sikur donte të linte përjashta brengën e madhe. Futi dorën në gji dhe preku lehtas dëftesën. Letra bëri kërt-kërt-kërt, sikur të paskej gojë e të thoshte: «Këtu më ke, këtu më ke...» Hodhi sytë majë maleve, tej horizontit të largët dhe ndenji një çast sa t'i terej ajo përlotje, që nuk i qe ndarë gjithë rrugës, që kur kish dalë nga shkolla. Para syve iu bë mësuesi, pranë dritares plot dritë, tek buzëqeshte e i thoshte:

«Lexo, lexoi këto dy fjalë!... Me rrokje!...»

Dhe veshët i buçisnin «Parti», «Enver».

Ajo hyri në konak e vendosur për ta shpurë gjer në fund dëshirën e saj, që tashmë i qe bërë qëllim në jetë.

I ati dhe hoxha bënë çmos që ta quanin të «dalë nga fiqiri» e ja qethën kokën për ta mbyllur brenda, që të mos përhapte «farën e çmendurisë». Mirëpo nuk arritën, se tamam dy ditë më pas Rufeja qe zhdukur nga fshati pa nam e nishan. Thoshin se ishte gremisur gjëkundë nga ndonjë buzë rrëpire, ose e kishin çarë kafshët e egra të maleve.

Hoxha dhe i ati nxituan ta quanin «shpirt i mallëkuar». Këtë gjë e bënë me ngut, që të mos përhapej «fara e çmendurisë» dhe «e pësonin» të tjerat. Sipas tyre, Rufeja nuk kishte më vend në fshat...

Ushtarët e togës së tretë, atë pasdite që po rrinin në lulishte, muarën vesh edhe diçka tjetër nga Aliu:

— Xhaxhai, që punonte në degën e brendshme, ka ikur në fshat. I është përgjigjur thirrjes. Më shkruan se në fshat sapo qenka kthyer edhe Rufeja... Mësuese, ama... Pas kaq vjetësh vajti përsëri në fshat!...

— Je i mërzhitur?

— Jo, jam i habitur... S'di as vetë se si jam...

## VII

Ai ishte ndofta ushtari i vetëm, që rrinte zgjuar, nga të gjithë ata që flinin në kapanon atë natë. Dhe gjithë kohën ai vetëm e vetëm lutej që ato dy net të pushonte, të flinte i qetë, si gjithë shokët. Eh, sa e dëshironte këtë!

Një ditë më parë mjeku u kishte bërë vizitë me nevrologun. Ky i fundit i godiste me një çekiç të vogël në tendinat e gjurit dhe këmba e lirë ngrihej sakaq e lëkundej disa herë si lavjerës. Me sa duket, mjeku provonte nervat periferike. Kështu bëri me të gjithë ushtarët.

Todin e vërejti një çik me dyshim, ai nevrologu i çuditshëm, që t'i ngulte sytë e të shikonte e s'e merrje vesh se si, me të qeshur apo me inat.

Pastaj erdhi puna te mjeku i repartit. Ushtarët, që qenë veshur vetëm me pantallona, ndjenin veten më të lirë e më të qetë. Edhe Todit iu duk se u qetësua ca. Mirëpo mjeku tundi kokën e rrudhi buzët.



— Ke tension gjaku të lartë... Nuk i ke punët mirë. Dukesh shumë i tronditur. Ke të drejtë, sidoqoftë... Nuk i thonë shaka të hidhesh me parashutë... sport është, po lodër nuk është... Ti je nga Myzeqeja... Hm! — ja bëri mjeku, që si i zhytur thellë në mendime, — Pa shtriu të të shoh edhe një herë shpretkën... të dhëmb? të dhëmb?... të dhëmb?..

— Jo. — Ushtari qe çuar më këmbë, pa prietur të mbaronte mirë doktori. Ai e dinte fare mirë se ku i dhimbte. Dhe ngaqë e ndjeu veten të fyer, zuri të mendonte: «Ç'do të thotë ky me këtë: sport është, po lodër nuk është?..»

— Ti, djalo, — iu drejtua mjeku, megjithëse nuk qe i ndonjë moshe për t'i thënë fjalën «djalo», që prapë e përsëriti: — Ti, djalo, je tip i ndijshëm... Je i shqetësuar nga diçka... Bën mirë t'i lësh mënjanë shqetësimet për këto dy net, që kanë ngelur... »

Ushtarit iu duk se mjeku do fliste akoma.

«Edhe një natë mbeti» mendoi «edhe një natë, veç kësaj që po ikën... Ku ma gjeti ditën kjo letër e nxituar!..»

Ai u kthye në anën tjetër, në krevatin e sipërm, mbylli fort qepallat dhe i shtrëngoi me dorë, saqë ndjeu se i dhëmbën sytë. Ra përmbys. Zemra zuri t'i rrihte me vrull.

«Do kujtojnë se u tremba: s'është shaka të hidhesh me parashutë... Nuk e tha kot ai mjeku këtë. Eh, kjo letër e nxituar!... Ç më bëri!.. Bën mirë t'i lësh mënjanë shqetësimet... Dy net... Edhe një mbeti... Kjo natë iku...»

Një ditë më parë, pas vizitës, ushtarët qenë ndarë në grupe, ashtu siç do të hidheshin, si të

kalonin edhe ato dy net, që kishin mbetur. Ata nja dy herë hipën në trupin e aeroplanit — model, që rrinte varur nëpër kavo çeliku. Qëndruan një copë herë, të ulur sipas radhës. Aeroplani lëkundej. Pastaj dëgjohej sinjali: një tingull i zgjatur sirene. Ushtarët ngriheshin dhe ndërkohë dera hapej. Todi qëndronte më këmbë, mu te dera. Veprimet i bënte me mendje, që i bridhte larg, sado që përpiqej t'i dëbonte ato që s'kishin të bënin me hedhjen. Ai do kërcente i pari përposh. Priste me ankth çastin, sa të mbaronte edhe kjo detyrë për atë ditë. Aeroplani lëkundej, duke imituar kështu disa lëvizje të përngjashme me ato në ajër. Përsëri sinjal: këtë radhë tinguj sirene të shkurtër, të prerë. Ushtarët kërcenin hop-hop e binin në tokë nga tre metra lartësi. Si e bënë nja dy herë këtë punë, i lanë të lirë.

Todi vuante për shkak të asaj letre, që po i prishte qetësinë. Brenda tij zunë të frynin erëra nga ato që trazojnë e ngrenë dallgë shpirtërore. Disa herë qe matur të fjalosej, së paku t'ja hidhte larg e larg Lirimit apo komisarit, qoftë edhe komandantit të prerë. Mirëpo guximi i largohej, sapo që kujtonte hedhjen me parashutë. Dhe ajo erë e brendshme, që po e turbullonte, e shtynte mënjanë, si varkë me velë pa timon.

«Bën mirë sikur t'i lësh mënjanë shqetësimet...» «Po pse kaq kollaj harrohet ky hall, more shokë?..»

Nuk mund ta besonte se njëherë do të merrte një letër të tillë, të rrëmbyer.

Atyre anëve qëkur kishin reshtur fjalët e liga për vajzat e reja. Dukej se të gjithë jetonin me një



mendim, si ta paskeshin shoshitur mirë e mirë punën:

«Ç'e keqe na gjeti, nëse çupat tona po i gjejnë vetë burrat?» thoshin të moshuarit dhe shtonin me qesëndi: «Vetëm lajmësi, ai i mjerë humbi në këtë mes...»

Mirëpo prapë u shfaq një lloj tjetër kundërshtimi i heshtur, i fshehur, që vërtitej derë më derë me dinakëri dhe që zor se i gjendej rrjedha: thashethemet. Kush i nxirrte këto? Nga buronte ky ujë i turbullt i nëndheshëm që, posa shpërthente, mbante erë ndyrësirë. Po a kishin të gjithë njerëzit nuhatje aq të përsosur, sa ta dallonin për së largu këtë rrjedhë të qelbur?... Rrjedha ishte tinzare, ajo nuk nxirrte krye kollaj... Njerëzit njomnin duart pa e kuptuar as vetë se si dhe kështu i zinte zgjebja: thashethemet!... Ato vërtiteshin derë më derë, vetëm pasi perëndonte dielli. Ato i fshihen diellit...

«Muarët vesh për filanen?... Dëgjuat gjë për çupën e... Më thanë se ajo... S'doli gjë edhe kjo... e pësoi nga qytetërimi Lira... Kështu i gjen ato, që hidhen shumë e s'dinë ta përmbajnë yryshin. E la ushtarin. Nëna e Todit e kish siktërisur nga shtëpia. Mos të t'i shoh sytë i kish thënë. Ç'ja bëri mirë!...»

Përziheshin e kërlësheshin llafet në errësirë dhe ngecnin në mendjen e njerëzve, si ai leshi i zi i dhenve nëpër driza.

«Mos të të dëgjojë ndonjë komunist, ore... Se unë kështu dëgjova... Mua mos më nakatos. Se atë Lirën e Uanit e mbrojnë shumë, ore...»

Todi i dinte të gjitha këto, por një copë herë të gjatë, pasi lexoi letrën, nuk mundi të

ishite i qetë. Ai së pari qërtonte të motrën për këtë punë:

«Përse Gora i vuri fjalët e nënës ashtu, tamam siç i ka thënë?» — Këtë e përsëriti atë ditë ngado që u ndodh.

«...Flitet, mor bir, pa ku di unë murga, sikur Lira paskësh zënë dashuri me një andej nga qyteti...»

Letrën e kishte futur në xhep, por një ndjenjë e panjohur, që s'e mernte vesh se nga i vinte, sikur i pëshpëriste: «Nxirre edhe një herë... lexoje prapë... ku dihet...»

«...Flitet... ku di unë... sikur Lira... andej nga qyteti...»

«Gjepura, që s'kanë anë...» thoshte me vete dhe dëbonte dyshimet me një të tundur të kokës. «Ç'budalla që bëhem!..»

Në këso rastesh kujtonte atë ditë, që e përcollën atje te lapidari. Lira i kishte thënë se do ta priste, ashtu siç pritet ushtari. Dhe rëmonte kujtesën më tutje, në vitet e rinisë së hershme, kur kish ndodhur diçka, që i jepte zemër edhe sot e kësaj dite.

Atëhere, që të dy punonin në arë, në një brigadë. Lira kishte ëndrrat e saj; ajo donte të bënte një gjë të madhe, si ta zemë, të mësonte për të ngarë traktorin, kombajnën apo kamjonin që do merrte për së shpejti kooperativa. Po nuk dinte në do t'ja linte radhën ndonjë djalë, që kthehej nga ushtria dhe a mund të rregullohej kjo punë... Kushedi çdo thoshin: Çup' e Uanit dashka të ngasë maqinë... Ua, ç'punë...»



Qëllonte që, duke u kthyer nga arat mbrëmave, ata kridheshin në botën e ëndrrave dhe, pa e kuptuar as vetë, mbeteshin fushës gjer sa andej i zinte errësira.

— Ku vanë? Ç'u bënë? — thoshte ndonjë nga të brigadës, për të ndezur më pas bisedë të gjallë, në rrugë e sipër, me qëllim, që edhe ai t'i shprehte së paku një shkëndijë dashurie shoqes së vet.

— Pse i zini ngoje? Dihet puna e tyre... Ata e kanë nisur që atëhere, kur shkonin me pata e biba — ja bënte ndonjë tjetër dhe shtonte:

— Le të shikojmë më mirë për vete...

Dhe atë çast, mu aty pranë veshit të shoqes, që mbante shatën në sup, dëgjohej një «Eh, sa mirë!...» mbushur me ngazëllim.

Kështu ndodhi edhe atë mbrëmje pas pune, andej nga arat buzë pyllit me pishë. Ata të dy qenë joshur nga ëndrrat e njëri-tjetrit dhe çapiteshin me nge e ca si të dehur. Ajo dehje e pakuptuar, që i kapte dendur, ndoshta vinte nga lodhja e ditës me diell të nxehtë, që u rrinte mbi kokë, ndoshta nga hapësira pa anë e fushës që kundërmonthe nga aromat e përzhitura, përzierë me erën e dheut. Përfytyrimi i fushës nuk dukej kollaj, sepse pas perëndimit, nga poshtë, zinin të ngriheshin hije të errëta. Dhe sa bukur ishte, kur mbi gjirin e ngrohtë të arave, ku nderej dalëngadalë tisi i mbrëmjes, të shihnje se si dridheshin yjtë e parë. Dhe s'kemi pse ta fshehim, ata që dashurohen ca më shumë i deh natyra, që i rrethon e u jep ndjenjë.

«Rrimë ca këtu!» u kishte thënë të dyve një

dëshirë guximtare, dhe ata s'e bënë dysh. Qenë ulur ndanë kavaletave, të cilat, në errësirë, zunë të ngjajnë me hije të çuditshme, që mend u zinin frymën. Lira u tulat një copë herë, pa ditur ç'të bënte. Ai e ndjeu gjendjen ku ndodhej ajo dhe i hodhi krahët në qafë. Lira nuk bëri zë. Ktheu fytyrën nga djali dhe ai shqoi sytë e mëdhenj, të mbushur me shkëlqim të gjelbër, nën dritën e mekur të perëndimit, që sa vinte shuhej. Ndjeu faqen e saj të nxehtë përvëlím dhe leshrat e ashpra që i ranë nëpër buzë. Aroma e atyre leshrave përngjante me aromat që shpërndante fusha atë mbrëmje.

Ashtu, duke shikuar yjtë, që rektinin mbi fushë, ata kushedi sa do kishin ndenjur, po të mos qe ngritur aty pranë një shushuritje e njohur.

Pilo Kulari, me çiften hedhur krahëve, zuri të vinte përçark kavaletave, siç bënte ngahera, kur mbi fushë ngriheshin hijet e zeza dhe yjtë e parë nisnin të dridheshin me rreze të pakta.

Por më kot e kënaqte veten me ato kujtime të largëta, se sakaq i turreshin mendime të tjera, që vinin përçark si një vorbull. Dhe prapë thoshte me ngadalë e më zë fare të ulët:

— Përse, përse të ndodhte kështu?.. Dyshon edhe nëna. Mos ka gjë të vërtetë? Ajo thoshte gjithmonë, kur qe llafi për kësisoj gjërash:

«Kush nuk ha hudhër, s'i mban erë goja». — Po halli? Mos vallë kishte të drejtë?..

Atij i qe bërë zakon, këtyre kohëve të fundit, që Lirimit të mos i fshihte asgjë. «Ç'më shtyri me këtë njeri. Mos vallë nga që i përngjet diçka Lirës?» mendonte ai dikur për shokun. Ndërsa tani Lirimi



thuaje ja dinte të gjitha. Kjo kishte ndodhur që atë natë, kur Todi iu shfaq për vështirësitë që ndjente në xhiroskop.

«... Edhe një natë mbeti... Edhe një natë veç kësaj, që po ikën...» Dhe atë natë ai ishte ushtari i vetëm, që ndenji zgjuar, gjer në orët e vona.

## VIII

«Ka diçka të ngjashme kjo letër me atë historinë e Rufesë» i kishte thënë Lirimi dhe pat vazhduar: «Të bie në mend? «Shpirt i mallëkuar», kështu e quajtën Rufenë... «Vajzë e përdalë» po i thonë Lirës».

Këto fjalë i dhanë zemër ushtarit. Ai kuptoi se, së paku një ditë e një natë, që kishte mbetur, i takonte vetëm detyrës dhe asgjëje tjetër. Përndryshe si mund ta quante veten ushtar? Duhej që me vullnetin e tij ta këmbente shqetësimin e asaj letre me shqetësimin e detyrës. Sikur ta urdhëronte njeri që të bënte kështu, me siguri që do ta kishte të vështirë. Se, në fund të fundit, këto nuk bëhen me urdhëra. Dhe mendja përsëri e pa u kuptuar i shkante te vajza:

«Kush e njeh më mirë se unë Lirën e xha Uanit? Ajo vetëm e çmendur do bënte ashtu... Po, po... vetëm e çmendur... Po, kush i nxjerr këto fjalë? Kush?...» dhe me këto u duk sikur kjo punë mori tjetër udhë.

Atë ditë Todi zuri të ndjente veten më të çlodhur, sikur të paskësh flakur tej një barrë të rëndë, që e pat munduar keqas.

Pasi hëngrën mëngjezin, ushtarët e togës së tretë muarën udhën për në aerodromin fushor, jo shumë larg dislokimit të repartit. Ecnin ngadalë e rëndë dhe mbanin një hap, ndonëse nuk u kërkohesh ta bënin këtë të fundit, megjithatë, te të gjithë ndjehej një farë plogështie. Edhe komandanti, sidoqë nga natyra që njeri i prerë e i sertë dhe i pëlqente pa masë hapi rreshtor, atë ditë nuk u ndie të bënte vërejtje për këso gjërash. Ishte i pushtuar edhe ai nga diçka, ndoshta nga e njëjta ndjenjë, që kishte pushtuar ushtarët.

Ata ishin nisur për në aerodrom. Do të hipnin nëpër aeroplanë, sipas numrave. Të nesërmen, me këta aeroplanë kishin për t'u ngritur lart dhe, prej andej, do të shkëputeshin për të rënë në tokë. . . Këso mendimesh bluanin në mendje ushtarët dhe ecnin ngadalë e rëndë.

«Nuk i thonë shaka të hidhesh me parashutë. . . Sport e quajnë, po lodër nuk është. . .»

Todin nuk e linin të qetë fjalët e mjekut të ri. Ky e kishte zakon të fliste shumë për parashutizmin, madje edhe me terma shkencore, sidomos të mbështetura në mjekësi, ndonëse vetë «me kokën e tij» s'e kishte provuar hedhjen me parashutë gjer atë kohë. Dhe ndoshta «hëpërhë» siç thoshte, nuk e kishte në plan ta bënte këtë gjë.

— Sepse nuk po e mbaj dot veten, besomë! — ja bëri Todi me zë të ulët.

Lirimi, sikundër ish duke ecur pranë shokut, ndenji një copë herë në heshtje, sikur donte që me këtë ta qetësonte tjetrin. Pastaj tha:

— Njeriut i shpëton kollaj fjala e papeshuar. . .



— Ke të drejtë...

— Ti e kupton se merakun i hedhjes nuk është i pakët, apo jo? Dhe te disa ngrihet tensioni i gjakut... Ku ta dinte mjeku, se ti ke marrë një letër...

— Po, po...

«Ç'ma shpure mendjen prapë tek ajo letër, o i uruar! Ç'më bëre!» tha Todi me vete.

Ecën edhe ca më tutje. Një aromë dehëse bari të porsa kositur vinte bashkë me erën, që frynte nga veri-perëndimi.

— Tek e fundit, lojë nuk është, apo jo?..

— Ke të drejtë... «Ke të drejtë... Ku dimë ne nga këto gjëra... Ne jemi marrë me tokën, me bimët, me bagëtinë; ja, për këto kemi haber ne...» — deshi të thoshte Todi.

Ai ishte gati t'i nënshtrohej çdo mendimi të shokut atë çast. Ecte duke i hedhur këmbët kuturu, me sytë mbërthyer diku, si ndonja pesëqind metra përpara. Së andejmi, në një fushë të blertë, si batanie ushtarake, shquanin aeroplanët, të vënë në radhë si me dorë.

«Këta janë aeroplanë të vërtetë, jo si ai që rri varur, atje në territorin ushtarak...» tha me vete dhe qeshi përse mendoi.

— Ja dhe aerodromi! — tha komandanti, që ecte aty pranë togës së tretë.

Aroma e barit sakaq zuri të ndihej e përzier me erën e karburanteve. Tani qenë futur nëpër aerodromin fushor. Dukeshin sikur e kishin flakur tutje atë plogështi që patën ndjerë tërë rrugës. Dhe këtë ndoshta e bënë për t'u rrëfyer aviatorëve, se qenë me të vërtetë guximtarë të qiellit, që

s'mbeteshin më pas se ata. Si kaptuan topilat me barin e korrur, që ishin vënë me kujdes mënjanë fushës, u ndodhën përballë dy rreshtash të gjatë me aeroplan.

— Sipas grupeve! — u dëgjua një komandë.

Ushtarët u shpërndanë dhe zunë vendet, ashtu siç do të bënin të nesërmen. Shkuan nëpër aeroplanë.

Aeroplani numër 134! Ja, ai aeroplani 134...

Todi qëndronte nën krahun e tij, që i nderej përmbi kokë, duke lëshuar goxha hije. Hija e aeroplanit po e pushtonte të tërin atë ushtar parashutist. Ishte një hije që s'e kishte provuar kurrë herë tjetër. Sërishmi zuri të ndjente një farë plogështie. S'e dinte as vetë, përse duhej të mendonte më parë, në atë çast.

«Si ngrihet në qiell tërë ky? Sa i madh qenka? Kushedi sa i rëndë është!... Dhe prapë fluturon... Ja, edhe dera... Nga ajo derë do të hyjmë ne... Ja edhe shkalla, ku do vëmë këmbën për t'u ngjitur... Nga ajo derë do dalim, që atje lart... Kur të dalim, s'do na lipset më shkalla!... Do vërvitemi nga ajo derë, pa qenë nevoja të vëmë këmbën në shkallë... Ç'motor i madh! Mos është ky ai, që është fikur në ajër!?...»

Todi kish lexuar një libër, që thosh se një aviator e uli aeroplanin me motor të shuar.

Gjë e madhe duhej të ishte... Kush do qe ai pilot?... Sikur ta shikonte!... Me siguri do të kishte qenë ndonjë shtatmadh e i fortë sa s'bëhet... Një lab, me siguri...

Ushtari kishte ngelur i hutuar nën hijen e aeroplanit, pa ditur nga të hidhte hapin. Sikur



të qe në grup me Lirim, ndryshe do të ishte puna.

Ndërsa grupi i Todit rrinte i lirë, aty ndanë aeroplanit 134, komandanti me grupet e tjera kishte nisur nga provat. Nëpër aeroplanë buçisnin sirenat, hipnin e zbrisnin ushtarët, që në çast kërcenin shpejt nga dera, përposh në tokë. Komandanti, ndonëse me moshë jo të re, bënte disa hedhje të sakta e të lehta, sikur të paskësh qenë një atlet i mirë dikur. Si hidhej i pari, ai zinte vend mënjane dhe vërente të tjerët:

— Këmbët!.. Puqi shputat!.. Përkuli gjunjët!.. Ku hidhesh ashtu, në pambuk, a?.. Shpejt, më shpejt!..

Komisari erdhi me vonesë në aerodrom. Hipur në një gaz, ai qëndroi mu pranë aeroplanit 134 dhe pyeti si me rrëmbim:

— Po këtu ç'bëhet? Si thoni, do hidhemi?..

— Oj të hedhur... — ja patën ca ushtarë. — Gati jemi ne, kur të dojë komanda...

— Ku është ushtar Todi Pisha? — pyeti komisar, jo pa qëllim. — Nuk po e shoh. Ai nesër do jetë i pari...

— Ashtu?!.. — thanë disa nga shokët.

— Ku je, o Myzeqar? — thirri Aliu me të madhe dhe vazhdoi.

— Paskë radhën të na udhëheqësh nesër...

Todi e dëgjoi për së largu këtë bisedë dhe sikur të ish zgjuar nga ndonjë ëndërritje, u çapit e doli nga hieja e aeroplanit. Rrezet e diellit i ranë mbi ballë dhe ai rrudhi sytë, për të parë më mirë, andej nga po e thërrisnin. Gjer para ca kohësh kishte pasur të bënte vetëm me tokën, këtej e tutje, në

jetën e tij, po hynte edhe qielli, me gjithë ato shqetësime.

Atë pas dite, kur u kthye me togën në territorin ushtarak, ai u end një copë herë të gjatë nëpër sheshin e rreshtimeve, nëpër qytetin sportiv dhe aty para dhomës kulturele. Kishte shumë gjëra, që po të qe herë tjetër, do t'i qëmtonte për të shkruar një letër... Një letër ushtari. Por kësaj here nuk i bëhej të mendonte për asgjë veç agimit të së nesërme, që pritej nga tërë të ishte e jashtzakonshme.

Në mbrëmje, sipas planit të komandës, mjeku do të merrej me matjen e tensionit të gjakut, për të shikuar kështu edhe një herë gadishmërinë e ushtarëve. Pas kësaj, ata duhej të bënin një gjumë të qetë e të thellë. Kjo kërkohej me doemos se ishte në rregulloren e parashutizmit...

«Po asaj letre si do i vejë filli?... Ç'bën Lira tashti?..»

Todi i kishte flakur tutje këto mendime, që mateshin t'i rrëmbenin qetësinë natën e fundit, po ato i qaseshin tinëz, si një kone që të ndjek këmba-këmbës.

«Qenka e rëndë, or shokë, or shokë! Të djeg mu këtu përbrenda...»

## IX

Komisari dhe komandanti, për tërë natën, duhej të arrinin në vendin ku do të bëhej desantimi, që të shikonin me kujdes veprimet e ushtarëve, pas zbritjes në tokë. Pasi kishin lënë udhëzimet e fundit me hollësi, ata i shtrënguan dorën shefit



të shtabit, dhe u përqaftuan me të, ashtu siç bëjnë përherë ushtarakët, kur ndahen.

Komisari, që dukej ca i shqetësuar, i kishte kërkuar një fletëleje shefit, gjë që këtij i qe dukur e çuditshme.

«Ç'e do fletëlejën ky?»

Kështu shefi i shtabit mbetej për të organizuar nisjen e desantit dhe, ndërsa ushtarët do të flinin të qetë, ai s'kishte për të vënë gjumë në sy. Me t'u thyer nata, ai u gjend në fjetinë për të pritur çastin e zgjimit. Rrinte dhe kontrollonte dendur orën. Më në fund dha komandën «çou!»

Kur u ngrit nga krevati, Todit nuk po i besohej të kish fjetur aq shumë. Sapo dëgjoi sinjalin e zgjimit, e dëboi përgjumjen njëherë e mirë. Nata e dytë kishte kaluar pa u venë re, ashtu siç shuhen netët e rëndomta në kujtesën e njeriut.

«Sa shpejt qenka!..»

Vetëm në alarme qenë ngritur kaq herët. Ndërsa këtë radhë veprimet nuk bëheshin aq shpejt si në alarm, nuk i priste ndonjë marshim i lodhshëm apo ndonjë stërvitje e rëndë në fushën taktike. Jo. Këtë radhë i prisnin «gazet» aty në sheshin e rreshtimeve dhe aeroplanët në aerodromin fushor.

Ushtarët, sapo zbrisnin në aerodrom nëpër mugëtirë, lëvrinin me gjallëri dhe, si vendosnin në krahë parashutën, zinin vendet pranë aeroplanëve. Më të rrallë dëgjohej ndonjë komandë a udhëzim, që zakonisht e jepte vetë shefi i shtabit, me një zë prej basi. Ky bridhte nëpër aerodrom dhe s'e zinte vendi, gjer mos të vendosej rregulli i nevojshëm, gjersa ushtarët desantë të lidhnin mirë e bukur

parashutat e të uleshin nëpër kabina. Vetëm atë-  
here shefi mendonte se do të mbetej i qetë.

Nëpër aerodrom herë pas here qëllonte të ndi-  
zej ndonjë fener me bateri, që jepte ca shenja  
me dritën e tij të gjelbër.

Agimi i asaj dite dukej sikur po vonohej. Ai  
kushedi nga rekëtinte, nëpër hijet e pasme të natës,  
tej, matanë maleve, që mezi shquanin, si bedene  
gjigante, në verilindje të aerodromit.

— Këtu avioni 134... Ku është desanti?...

Feneri me atë syrin e gjelbër bënte shenjë  
andej nga vinte zëri.

Todi ecte përpara grupit, me hap të matur,  
duke ndjerë mbi shpinë peshën e parashutës. Rri-  
pat e trashë, të fortë, që kalonin në supe, në gjoks,  
në mes të kofshëve, e mbanin pushtuar trupin e  
tij, si ndoca krahë, që donin ta ngrinin peshë. Këta  
rripa ai i kishte lidhur edhe disa herë të tjera,  
por, si këtë radhë, nuk i pati ndjerë kurrë. Ai do  
të donte që ta shtrëngonin edhe më shumë këta  
rripa.

«Rripat duhet të jenë të puthitur... Të mos  
lëkunden... Kontrolloni njëri-tjetrin...»

Këtë punë e kishin bërë dhe po shkonin drejt  
aeroplanit. Bari i korrur kërciste nën këmbët e  
tyre. Edhe pakëz tokë kishte ngelur gjer te shka-  
llët e aeroplanit. Ata do të ndaheshin me tokën.

— Këtu avioni 134!..

Syri i gjelbër i fenerit, që dukej sikur bu-  
ronte së thelli në errësi, vështronte me trish-  
tim këmbët e ushtarëve, që afroheshin tek ai.

Grupi i desantit u ndal. Ushtarët rrinin në  
heshtje, të vendosur në dy rreshta të gjatë, që  
humbisnin në mugëtirë. Ishte qëndrimi i fundit



me këmbët në tokë dhe ata mendonin vetëm për hedhjen që i priste.

Një nga pilotët me sa duket, komandanti i ekuipazhit, u afrua duke ecur i shkujdesur, me atë shtatin e gjatë e të plotë, pak të kërrusur përpara. Pas tij çapitej ai që mbante varur poshtë atë syrin e gjelbër të dritës. Silueta e pilotit ngjante sikur qëndronte pezull në errësirë.

— Kur të ngriheni për hedhje, mos u afroni të gjithë te dera, sepse, siç e dini, qendra e peshës shkon në bisht dhe ne do ta kemi pisk... — tha piloti dhe, si shpjegoi sinjalet e shenjat, zuri të bënte kontroll nga ana e tij, së bashku me shokun tjetër. Ata qëndronin me dritë në dorë pas çdo ushtari; tregoheshin të kujdesshëm dhe interesoheshin së tepërmi për rripat.

«Ç'thotë ky: siç e dini vetë?.. Ku dimë ne nga këto...» Mendonin ushtarët dhe, po të qe tjetër herë, do t'ja krisnin të qeshurit dhe ndosh-ta kishin për të pyetur: «Ç'është kjo qendra e peshës, që shkoka në bisht?» Mirëpo ato çaste s'donin ta pengonin pilotin në kontrollin që po bënte. Atyre u pëlqente pa masë, kur ai i prekte me dorë në rripa e në parashutë e u dukej sikur merrnin forca të reja besimi.

Pastaj, të gjithë me komandë u kthyen nga dera e aeroplanit, atje ku qëndronte varur ai sy i gjelbër drite, dhe nisën të hidhnin hapat e fundit nëpër tokë. Zunë të dëgjoheshin me radhë këpucët e rënda ushtarake, tek hipnin në shkallë. Nëpër derën e errët, që përngjante si grykë tuneli, desantët kridheshin në errësirën e kabinës, sikur t'i thëthinte diçka nga brenda.

Tashti që i kishte parë të gjithë shokët se si ishin futur në aeroplan, Todi bëri edhe vetë atë copë rrugë nëpër tokë. Syri i gjelbër i fenerit i ra në fytyrë dhe shkau me ftohtësi gjer te shkalla. Ushtarit iu bë sikur, tashmë, dy sy të gjelbër po e ndiqnin me një vështrim të kujdesshëm nga prapa. Vuri njerën këmbë në shkallë, peshoi mbi të, dhe sakaq këmba tjetër u nda nga toka. Ai hyri i fundit që, më pas, nga ajo derë të vërvitej i pari në hapësirën e misterhme që e priste. Edhe në kabinë vezullonte një llambë jeshile.

Në shpinë ndjeu peshën e parashutës dhe kujtoi ato katër duar, që kishin mbyllur kapakun e saj, duke shkuar nëpër kopsat e unazave një fill teli të sertë. Kjo i përngjante qepjes së një të çare operacioni, por me një ndryshim, se ai fill teli mbante brenda të kyçur një jetë: gonxhen gjigante të parashutës. Me t'u hequr ai fill teli, hapej kapaku dhe shpërthente në ajër kupola e bardhë, që dukej sikur e pushtonte ushtarin me ca krahë të fortë, për ta zbritur pastaj në tokë.

«Do ngrihemi në qiell, nëno! Dhe që andej do hidhemi...»

Ndërkaq, në kabinë zunë të kalonin aviatorët, për të shkuar në vendet e tyre, dhe dera u mbyll. Vezullimi i gjelbër mbeti jashtë.

«Me sinjalin e parë dera hapet, ngrihemi... Sinjali i dytë... hedhje. Mezi arrita gjer këtu... Kaq e pati edhe puna e qiellit...» — mendonte Todi.

Ushtarët desantë rrinin ulur në dy radhë ngjeshur pranë njëri-tjetrit dhe dukej se atë kohë pris-



nin sinjalin, ndonëse kishin për të bërë një fluturim të gjatë për gati një orë. Nga dritaret përballë, dallonin rektimën e largët të agimit të asaj dite.

Aeroplani u drodh nga zhurma. Dridhjet s'pëshonin. Ishin ca dridhje, që, së bashku me zhurmën, të hynin m'u brenda në gjoks e të ngacmonin, të dehnin. Si zakonisht, mendimet nisën të merrnin nëpër traga të ngatërruara.

Brenda në kabinë u ndien lëkundjet, troshitjet; objektet e ndriçuara shkisnin prapa, si kometa të largëta. Aeroplani po ecte nëpër tokë, zhurmë, dridhje, troshitje.

Todit iu kujtua ikja nga fshati me kamionin e mbuluar të Lirës. Iu bë sikur, diku prapa, shqoi siluetën e nënës, ca më tej, xha Uanin, që peshonte mbi bastun, lapidarin që vezullonte... dhe, i mëkuar me mall, sa nuk thirri si atëhere nga kamioni, me zë të lartë: «Mirupafshim!»

Sikur ta kishte bërë këtë, kjo do të ngjiste si përsëritja e të gjithëve, sa qenë aty, me tokën e njerëzve, të bimëve e të kafshëve, me dheun e vlagën e tij.

Mirupafshim!

— Ikëm, shokë, — tha dikush. — Ikëm...

— Jemi në tokë — ja bëri Aliu.

— Në tokë!.. jemi në aeroplan...

Ushtarët qenë gjallëruar. Të shumtë qenë ata që po bënin fluturimin e parë dhe thuajse e harruan hedhjen e parë.

Pilotët shikonin punën e tyre. Ata, si zakonisht, dukeshin indiferentë karshi ushtarëve parashtistë, që rrinin në bortin 134. Todi i vërente

për së largu dhe s'dinte ç'të mendonte për ta.

— Thonë se edhe pilotët hidhen me para-shutë — i tha në vesh shokut aty pranë. Ky ngriti supet dhe mblodhi buzët.

«Këta tërë jetën e kanë lidhur me qiellin, si ne me tokën». — mendoj ai.

— Tokë.. — ja bëri ushtari me zë — dhe qiell... .

Në gjysmerrësirë, aeroplani 134 zuri të vraponte me zhurmë rrëqethëse nëpër aerodromin fushor. Kabina gumëzhiu rëndë. Rrotat, me sa duket, hasnin tokën e valëzuar dhe e troshitnin së tepërmi aeroplanin.

— Ikëm... .

Ushtarët paprerë ndjenin një forcë, që i shtynte për nga bishti dhe që sa vente pakësohej. Natyrisht, ata as që e vranë mendjen të gjenin se ç'ishte kjo. Në fund të fundit, gjersa hipën në aeroplan, shumë gjëra të panjohura do të provonin. Së paku këtë e dinin të gjithë. Ata shikonin nëpërmjet iluminatorëve dritat e largëta, që ngjanin sikur përplaseshin në errësirë e humbisnin pa nishan. Kur u shkëputën nga toka, troshitja dhe dridhja reshtën. Lundrim i qetë në ajër. Mugëtirë, që shkrihej në lindje. Vetëm zhurmë, vuvurimë motori. Ata që rrinin në kabinë se qysh i dehu një rehati e jashtzakonshme. Sytë po u mbylleshin pa e kuptuar as vetë nga se. Diçka e panjohur e pakapshme i ndrydhte lehtë-lehtë nga koka te këmbët. Me përtesë ngrinin kryet për të parë. Atyre as që u shkante në mend se tërë këto vinin nga që aeroplani fluturonte me marrje lartësie të shpejtuar.



Aeroplani, me numër borti 134, kishte marrë udhën ajrore, në kurset më afër jug-jugperëndimit, drejt një vendi buzë detit, që mbahej i fshehtë, ashtu siç mund të bëhet kjo punë në ushtri. Atë vend e dinin tre veta: Komandanti, komisari dhe shefi i shtabit. Madje, edhe piloti, që do t'i çonte gjer atje, njihte vetëm kuadratin në një fushë buzë gjolit, që kishte detin Adriatik nga perëndimi. Kaq dinte: atë kuadrat, ku doemos duhej bërë hedhja e saktë e desantit ajror. Në hartën e fluturimit ishte edhe një fshat i vogël ndanë një pylli, i rrumbullakosur në një rreth të kuq, shenjë kjo e pikës së fundit të itinerarit të marshrutës. Mirëpo pilotit nuk i interesoonte emri i këtij fshati. Ku i shkonte në mend atij se në bort rrinte dikush, që e njihte mirë atë fshat, atë copë tokë, në mes dy kufive ujorë.

Ushtarët vështronin me habi nga iluminatorët dhe ndjenin kënaqësi.

«Eh, sikur ta dinit ku ndodhemi tashti!» mendonin ushtarët.

Todit i bëhej sikur toka e bytyntë rrëshqiste me plogështi, ngrihej, ulej, rrotullohej diku larg. Sa e sheshtë i dukej toka! Tamam siç e rrëfejnë hartat... Ai nuk do të mund të shquante që andej, as dallgëzimet më vigane të tokës.

Ushitari e kishte lënë përfytyrimin t'i bridhte larg, në kohëra dhe njerëz, jashtë asaj kabine, ku ndodhej i ulur.

I qe kujtuar se dikur, në fëmijëri, mbi gjolin i përhimtë, një mëngjez me mjegull të ulët, ish shfaqur papritur një aeroplan i çuditshëm, me zhurmë të pakët. Fluturonte shtruar, majë kashtës

së gjatë, që hepohej nën krahët dhe lëshonte një bisht, që përngjante si tym i kaltër dhe që binte ngadalë në gjol.

Në fillim ai e shikonte si në ëndërritje atë aeroplan dhe, kur ai zhdukej, zinte e bënte fjalë me Lirën, që s'dinte më shumë nga sa dinte ai. Pastaj, kishte dëgjuar nga fshatarët se atë aeroplan e ngiste vëllai i Leksit, që shërbente në aviaçion. Këto fjalë natyrisht s'kishin qenë fare të vërteta se, siç mësoi nga një oficer aviator, vëllai i Leksit na qenkish ndërlidhës e jo pilot. Todit s'para i erdhi mirë nga sa kishte dëgjuar për vëllanë e Leksit.

«Të ishte me qenë pilot...» kish menduar Todi atëherë.

Hodhi sytë në kabinën e pilotëve dhe vuri re se këta vërenin me kujdes e dendur tokën poshtë dhe, pasi shikonin edhe hartën, këmbenin ndonjë llaf ose ndonjë shenjë me kokë.

Todi, si shumë të tjerë, gjer atë ditë kishte menduar se, për të parë tokën, pilotët duhej të qenë të pajisur me dylbi.

Aviatorët dukeshin të zënë me shumë punë. Pas tre çerek ore, aeroplani po i nxirrte jo aq larg bregut të detit. Ai gumëzhinte paprerë nga zhurma e motorit dhe fishkëllimat e ajrit, që e rrihnin në krahë, në trup e kudo. Fluturonte me ngulm drejt jugperëndimit dhe gllabëronte ethshëm largësitë e fundme të udhës. Udhëtarët rrinin të qetë, të heshtur. Këta udhëtarë qenë më se të sigurt se, në fund të fundit, do të zbrisnin në tokë, sido që të bëhej. Ata mbanin mbi kurriz parachutën. Dhe, megjithëse sapo ishin



njohur me atë maqinë fluturuese dhe me ekipazhin e saj, u dukej si ta kishin bërë qindra herë një udhëtim të tillë.

Si kaloi një copë herë, nga koha kur aeroplani kishte bërë një kthesë nga e majta, piloti i ri, që rrinte në sedilen e djathtë, se qysh ktheu kokën prapa dhe buzëqeshi! Të gjithë e vështruan me vërejtje, po s'kuptuan gjë. Duke bërë ca shenja me dorën e majtë, ai, me sa dukej, përhapi sinjalin e parë në kabinën e desantëve. Sirena e rëndë buçiti. Edhe aty në kabinë një sy i gjelbër drite ndizej e shuhej me tingujt e prerë të sirenës.

«Mjaft me këta tinguj!... Ne jemi gati qëkur...»

Dera e bortit qe hapur.

Papritur Todit iu mufatën veshët nga një fërtymë e mistershme. Nga dera e hapur hynte brenda fishkëllima e rrymave të ajrit, e përzier me guditjen e motorit.

Ai u qas mu në buzë të derës. Madje maja e këmbës së djathtë i kishte dalë ca nga borti i aeroplanit. Silueta e trupit të tij të madh zinte gjithë dritën, që mundohej të hynte nga dera.

«Tamam si në përrallë!..»

Tërë ajo sipërfaqe larushe e tokës dhe ngjyra e kaltër e detit u shfaqën në sytë e ushtarit papritur e me një pamje të madhërishtme.

«Ku e kam parë një bukuri si kjo?..»

Atë kohë sytë i vanë te maja e këmbës, te borti, te vendi i shkallëve, me të cilat ai qe ngjitur nga toka në aeroplan. Për një çast sesi iu kujtua: sa me mospërfillje qe ndarë nga toka.

Tashti me një kërcim në ajër, do t'i drejtohej prapë asaj...

«Sa larg qenka toka!..»

U duk sikur ajo pamje aq e bukur ngriu, si një kuadër filmi që ngec. Asgjë nuk lëvrinte atje poshtë, sikur priste se ç'udhë do të merrnin punët...

Ishte hera e parë që shkëputej nga toka. Ishte hera e parë që ngrihej në qiell, që fluturonte me parashutë në kurriz e automatik të varur në qafë.

Brez pas brezi njerëzit e tij ishin marrë me bujqësi. Kishin çarë tokën me parmendë dhe kishin thërmuar plisat me dorë. Edhe me shpirt në dhëmbë, nuk ishin ndarë nga dheu.

«Dheu na mban gjallë, dheu do na hajë» thoshin bujqit, në ato kohë të zeza dhe hiqeshin zvarrë fushës, gjithë ditën pas parmendës, duke ndjerë mbi krye qiellin e rëndë, shtypjen e egër. Dhe dëgjoheshin ugareve nëpër brazda thirrje të mekura: Ohaaa, oha, plaç!»

Edhe sot dheu është po ai, i murmë dhe i çarë në brazda. Ndërsa njerëzit kanë ndryshuar dhe veglat janë bërë më të fuqishme.

Todi ishte bujk, para se të vente në ushtri. Ai do të mbetej bujk kooperativist. Natyrisht, s'e kish çuar kurrë në mendje, por e deshi puna, që të ndahej për ca kohë nga toka, nga afshi i saj, të cilin e pati thithur tërë jetën.

«Na ka hyrë në palcë era e dheut...» thoshte ai gjithnjë dhe fshatarëve të moshuar u bëhej zemra mal.



«Ne duam ta bëjmë fshatin si qytet, dhe jo ta këmbëjmë me qytetin».

Shokëve të ushtrisë u bëhej qejfi. Ushtar Aliu tundte kokën, sikur donte të thoshte: u pa puna, fshati na pret...

Todi shikon poshtë nga dera e hapët. Në ballë i përplasen rrymat e forta të ajrit, që i përлотin sytë. Toka zë e lëkundet e çrregullt dhe mbulohet nga një si mjegull.

Edhe ai nisi të lëkundet e të lëkundet te dera... Një mendim i egër po i zbriste heshtazi nga koka te këmbët, që po i dridheshin nën rrymat e forta të ajrit.

«U prapse?!»

Nëna iu shfaq e lemeritur. Ajo nuk do ta falte kurrë një gjë të tillë. Vërtet që e kish parë të birin, si dritën e syve, dhe drithërohej për të, por pse në fund të fundit? Përse i kish bërë gjithë këto?... Asaj do t'i dridhej dyfish zemra, nëse do mësonte, se barku i saj paskej pjellë një që s'i ngjante t'et, gjyshit, stërgjyshit... moshatarëve të tij. Me ç'sy e faqe kishte për të dalë në fushë?..

Po emri i t'et si do duronte atje në pllakën e mermetë të lapidarit?..

«Vetëm ti bërë mënjanë? Vetëm ty t'u dhimbs jeta? Po të tjerët si bënë?! Ata nuk qenë bij në-nash?!»

Kur e nisi ushtar, ajo i tha: «Bëj si të thonë, bir...» Dhe kishte menduar: «ku di unë e mjera për ushtrinë!..»

Ajo sigurisht do të mallëkonte një herë barkun dhe gjirin e saj, atë zemrën e lëshuar, që s'kish

ditur t'i jepte të birit guximin e nevojshëm për të mundur frikën... për të fituar mbi vdekjen.

«Ç'polla unë murga dhe ç'paskam mbajtur në gji!» Do thoshte nëna.

Ushtari hodhi një hap para, nxori këmbën nga dera; u mbajt fort me duar pas bortit. Nën të po afroresh një fushë e përhimtë...

«Oh, sa e rëndë kjo vonesë!..»

Ju bë sikur në vesh dëgjoi të qeshura... «Të qeshurit e Isait! Të qeshurit e armikut! S'do ketë gjë më të vrazhdë se kjo...»

Një shkëlqim i gjelbër ngrihej nga poshtë dhe i futej në gjoks...

«U prapse?..» Sikur i thosh nëna.

«Ha, ha, ha, haaa!» sikur qeshte Isai.

«Sa hije të paska ajo uniformë dhe ai automatik!..» sikur i thoshte ai shkëlqim i gjelbër, ledhatonjës.

Po i mereshin mendtë. Çdo gjë vinte për qark e ziente si në një vorbull nën këmbët e tij. Kështu i qe bërë dhe ditën e parë, kur ishte futur në xhiroskop, në ata rrathë rrotullues.

Todi ndjeu mbi supin e djathtë një dorë, që e shtrëngoi.

— Sinjali i dytë... E dëgjon?..

## X

Disa ushtarë të togës së tretë, pasi maskuan parashutat në vendin e zbritjes, muarën për nga pylli, ku, sipas detyrës, do bashkoheshin me shokët



për të vepruar më tutje. Ecnin me nxitim, duke mbajtur shtrënguar automatikun e pajimet e tjera. Herë-herë këmbët u ngecnin nëpër dega e shkurre dhe ata i hiqnin me kujdesin që tregon zbuluesi, për të mënjanuar zhurmën. Sepse dihet që zhurma, apo shenja më e vogël e mbetur pas, është tepër e rrezikshme për të.

— Nxirre një çikëz pagurin të lagim buzën se u zhuritëm.

— Jo, Ali. Duhet të shpejtojmë. Ç' thua kështu?

— Vdiqa... m'u zu fryma!..

— Shshst! Ç' thua kështu? Dielli sapo ka dalë..

— Nuk di sepse ndjej zagushi, u dogja...

— Të bashkohemi një herë me shokët...

— Ku do takohemi? Nuk marr vesh ku jam.

Më duket vetja si i kredhur në pus.

— Shshst! Mba vesh!.. Dëgjon?..

— Jo.

— Përgjo më mirë. Shtrihemi!..

Ata ranë barkas, duke u bërë njësh me tokën. Ca filiza marine ishin aty përpara dhe ata, këmba-doras, u avitën e futën atje grykën e automatikut. Era e dheut i ngacmonte flegrat ushtarit.

— Ku...

— Mos bëj zë!.. «S'është kollaj t'i zbresësh armikut mu në vatër» deshi të shtonte ushtari.

Zbulues të tjerë qenë afruar nga e djathta dhe gabimisht kishin marrë për nga gjoli.

— Djalli ju marrtë! Ju qenki? Çou, Ali...

— Ku do vemi?

— Në pyll... Në vendin e takimit.

— M'u tha buza...

— Nxirr pagurin dhe lage.

— Nëm pagurin tënd se mua më ka shkuar prapa kurrizit. . .

— O, ho, ho! — ja bëri Aliu, si piu ujë nga paguri i shokut dhe shtoi me rrëmbim:

— Shikoni andej! Pluhur që vrapon: maqinë. Po na ndjekin.

Sipas planit të komandës, çetat vullnetare racionale duhej ta pengonin zbuluesin në detyrën e vet, ndoshta edhe ta mbyllnin në «çark», për të mos e lënë që të lëvizte andej-këtej!

Zbuluesit, nga ana e tyre, do të takoheshin nëpër pikat e caktuara që pastaj, prej andej, të nisnin vëzhgimet. Secili e dinte vendin e takimit. Ushtarët e togës së tretë shtyheshin për në krahun lindor të pyllit, nga dy e nga tre, ashtu siç patën rënë në tokë. Kur të bashkoheshin, do dilte zbuluesi i parë, që do hapte rrugën për hyrjet drejt qendrës së fshatit, ku supozohej të qe shtabi i një rigrupimi forcash.

— Ju, nisuni. Prej këtu ecni drejt, pa u kthyer gjëkund. Vetëm një kanal kini pengesë. Më të djathtë do t'ju zënë sytë ca kavaleta. . . Unë po pres të tjerët. . . — u tha Todi shokëve të togës.

— Kaq mirë i ditke shenjat dalluese ti? Je i bindur? — pyeti me dyshim një nga ushtarët.

Ai u hutua për një çast. S'dinte ç'të thoshte. Mirëpo shpejt e mori veten!

— Kështu si u them, s'do t'ju vejë keq. . .

— Prandaj shikonte me vëmendje nga dera e hapur ky. . .

— Ju kam thënë unë; ata që nuk ta mbushin synë, dalin betër në këto punë — ja bëri Aliu, që përpiquej t'i merrte pagurin shokut.



— Ikëm!

— Shkoni. Diellin mbajeni prapa. Mos ndërroni udhë.

— Sa vapë ka për të bërë! Do ngordhim për ujë...

— Shshsht! Nisu me shokët. Unë do qëndroj vetëm.

— Uf! Harrova. Nëm dhe një çikë të pi...

Sapo që e kuptoi se mbeti vetëm, Todi u ul, mbështeti kokën në pëllëmbë dhe ra në mendime. Nuk arrinte ta besonte atë që kish ndodhur: pas afro një ore nga nisja, nga ndarja nga toka, ai gjendej kaq larg... në tokë, në fshatin e tij... I dukej si ëndërr, kur kujtonte se aty kish zbritur nga qielli, dhe ku? Mu aty ishte çapitur qindra herë, kryq e tërthor.

«Si është e mundur?!...» përsëriste ushtari.

Ai ishte në tokë, në ato ara, ku thërmonte plisat dikur me duar. Sërishmi ndjente erën e dheut, pas ndarjes së shqetësuar që pati. Ishte në mes të shokëve...

Ushtarët e togës së tretë, që shtyheshin rrëmbimthi për nga pylli, në perëndim, ecnin me zigzage. Kështu u qëllonte që papandehur t'u dilte përpara Todi, ose zëri i tij. Në këso raste, ata menjëherë përplaseshin nëpër shkurret më të afërta dhe merrnin pozicion për ndeshje. Këmbein parullën dhe vetëm atëhere shkonin pas rrugës, që u rrëfente shoku.

Sapo që ngelej vetëm, ai përsëri binte në mendime. Shqetësimet e qiellit kishin reshtur dhe, me sa dukej, u lanë udhë të lirë atyre të tokës.

«Si të bëj?.. — vriste mendjen. — Të kërkoj

nënë, Gorën?.. Dhe t'i pyes për atë letër... Po detyra? Jo, jo! S'më duket me vend... Po edhe zemra s'më bën për asgjë...»

Për së largu vuri re se drejt tij po afrohej një mëshqerë larushe. Doli me kujdes nga vendi ku rrinte fshehur. E priti mëshqerrën dhe e ndolli. Ajo ktheu kokën mënjanë, sikur donte të thoshte se i trembej njeriut me veshje të çuditshme. Ush-tari zgjati dorën dhe e ndolli sërishmi, këtë radhë me një shprehje sa më të butë e më të dhimsur në fytyrë. Ai nuk shtirej aspak, përkundrazi ndjen-te një mall të vërtetë.

— Hajde, hajde... mos u tremb — ja bëri dhe u çapit më tutje. Mëshqerra ngriti kokën për të parë njeriun. Sytë e saj të mëdhenj e të xhamtë me qerpikë të rrallë e të lakuar si fije teli i ngjallën trishtim ushtarit. Ai bëri edhe dy çape dhe zuri ta ledhatonte kafshën e urtë, duke ndjerë në pëllëmbë afshin e zverkut të saj.

«Nuk më njeh? Ke hakë... ishe e vogël atë-herë...»

Pastaj e çoi mëshqerrën drejt pyllit dhe e la të ecte përpara.

«Do na hysh në punë sot...»

Atë çast, nga ana e pyllit, si ndonja pesë-qind metra larg vendit, ku qe fshehur Todi, u ngrit në qiell cinxërима e larashit. Ky ishte zogu më i dendur stinës në këto fusha. Todi mbajti vesh. Larashi e përsëriti cinxërimën e tij tri herë dhe pushoi gjatë. Todi priti një copë herë... zogu nisi prapë.

«Erdha!»

Ai la vendin duke mbuluar gjurmët dhe, si



vuri mëshqerën në krahun e djathtë, bëri tutje nga pylli, ku e prisnin shokët e togës. Larashi me cinxërimën e tij e shpuri gjer në vendin e takimit.

— Sa mirë të paska shkuar mendja...

— Për fat, mëshqerra duket e urtë.

— Do lodhet ca, po do ta shpërblejmë, apo jo? — tha një ushtar.

— Ore, po le nam ti... Pa më jep një çikëz pagurin... Si do bëj me këtë ujin e fushës!...

Todi u ul e ndenji pranë shokëve, i mbështetur pas trungut të një pise, me automatikun varur në qafë dhe bashkoi gjunjët me duar.

Nëpërmes trungjeve ata shihnin fushën, që shtrihej para syve të tyre. Që aty ku ishin ata, dukeshin fare mirë arat, që po mbuloheshin ca nga ca nën rrezet përvëlonte të diellit. Hamulloret e djegura kundërmonin erë shkrumb. Fusha e e shkretë, matanë arave kishte zënë të reflektonte pellgje të gënjeshtërt uji. Ndërsa pullazet e kuqe të shtëpive, që radhiteshin në mënyrë të rregullt, dhe godina e lartë në mes shquanin fare mirë. Ky ishte fshati, drejt të cilit ushtarët do fillonin zbulimin.

Mëshqerra, ndonëse e pangjacular nuk lar-gohej, po aty përçark gjëllinte nonjë tufë bari rrezë trungjeve.

Pas pak, Todi me mëshqerën larushe ishte nisur në detyrë. Nuk qe e lehtë ajo rrugë nga pylli në fshat. Zemra e ushtarit rrihte fort dhe e shqetësuar. Dihaste me zor. Trupin nuk mund ta drejtonte për asnjë çast, veç kur shtrihej në tokë e tulahej sa të sqarohej ndonjë lëvizje e

dyshimtë. Djersët i këputeshin si kokrra misri dhe binin paf-puf mbi dheun e përzhitur, që s'pyeste për kripësirën e tyre. Thereckat e fshehura anës së ledheve e pickonin hidhur, por ai nuk qe i ngeshëm të merrej me to.

Mëshqerra e bënte udhën sipas qejfit. Sorollatej kot, ose hidhte kokën mënjanë dhe fshikte me bisht mizat e shumta të fushës, që e trazonin në veshë e në vithe. Nganjëherë i shkreppte të sulej për të rrëmbyer një gojë misër të njomë.

Për tërë këto ushtari duhet ta falte mëshqerrën, madje ta merrte edhe me të mirë, përndryshe ajo mund ta braktiste a të ikte, po t'i donte qejfi. Domsodo, ushtari e kuptonte kafshën, prandaj e fërkonte në gushë, në bark e kudo dhe i zbonte mizat nga veshët e vitet. I shërbente, në ecje e sipër, me se të mundte. Gjer atëhere, nuk i kish shkuar kurrë në mendje, se do të vinte puna, që të bënte një rrugë të tillë si ajo, sipas tekave të mëshqerrës.

Kështu Todi vajti dhe erdhi disa herë nga pylli në fshat e në të kundërt dhe u miqësua shumë me mëshqerrën larushe. Në librin e zbulimit të togës së tretë, shtoheshin të dhëna si këto: Në godinën e kryesisë, është vendosur shtabi... Godina ruhet me katër vullnetarë... Në shesh mbërriti një autokolonë... Përqark fshatit lëvizin patrulla të shumta... Nëpër fshat ka vetëm njerëz me uniformë e të armatosur... Më të rrallë duken pleq... Një kuzhinë e ngritur para klubit pregatit gjellët, ndoshta për një batalion...

Aty nga ora dymbëdhjetë e asaj dite, mbi fushë, zuri të ngrihej era e detit. Pylli fëshfërinte



ëmbël. Kupolat e mpleksura të pishave qëndronin mbi trungjet e gjata dhe sajonin një çati të gjelbër, që i fshihte ushtarët nga syri i zjarritë të diellit.

— Mjaft. Duhet të pushosh. Të është zbardhur gjimnastjorka nga djersa...

— Edhe mëshqerra duket e cfilitur...

Todi rrinte i mbështetur pas një tringu, me sytë gjysmë të mbyllur dhe me përtesë bluante në gojë racionin e drekës me djathë kaçkavall. Kur mbaroi së ngrëni, nxori pagurin nga rripi dhe e tundi se iu duk i lehtë. U habit kur pa që ishte i zbrazur. Gjer në atë minutë ai nuk e kishte vënë pagurin në buzë. Ku dreqin kish vajtur uji, nuk i kujtohej.

— Jepi, të shtyjë kafshatën, Ali.

— Po ju thashë, more shokë, që s'e pi dot ujin e fushës...

Todi vuri buzën në gaz, duke vështruar shokun. Ai e dinte mirë se asnjëri nuk do t'ja kursente pagurin, qoftë edhe Aliu. Por i vinte rëndë se do thoshin që paguren e tij e kishte tharë vetë.

— Jepi Todit, jepi, Ali, se nuk të pinë ujë ato që thua...

Qeshën me zë të ulët të gjithë sa qenë.

— Kjo Myzeqeja jote ujë ka plot, o Todi, por s'vihet në gojë...

— Si të rrish ca ditë, mësohesh, — u përgjegj ai pa e pasur mendjen aty.

— A, pa, pa, pa! — ja bëri Aliu dhe shtoi me nxitim! — More Todi, harruam të të pyesim: ku bie ai fshati yt?

Ushtari, i zënë gushtë, hodhi sytë vetëtimthi nga shokët. Ata prisnin. Kuptohej se të gjithë men-

donin njësoj: fshati i Todit pritej të qe diku afër dhe ndoshta mund të tregohej prej andej.

— Këtej, bie, — murmuriti ushtari dhe u çua më këmbë. — Po iki — tha dhe nuk e bëri të gjatë.

Këtë herë e shqetësonte pa masë mendimi se ai mund të zbulonte diçka për vete, për nënën, për Lirën... Si do bënte kur të vinte mbrëmja? Ai e dinte fare mirë se, me të rënë muzgu mbi fushë, stërvitja do merrte fund. Ushtarët kishin për t'u mbledhur në sheshin e fshatit e, prej andej, me autokolonën do merrnin rrugën e gjatë të kthimit në repart.

«Si do t'i vejë filli kësaj pune?.. Me ç'sy e faqe do të dalë para shokëve, para fshatit? Qenka e rëndë!..» mendonte.

Me këto mendime kishte sosur në të hyrë të fshatit. Aty qëndroi një copë herë të gjatë, me fytyrën të mbuluar në ca shpendra, që s'e linin të lëvrinte shumë. Vëzhgonte për së largu dhe vriste mendjen si të bënte më tutje. Për të hyrë në shtëpi, andej ishte rruga më e shkurtër. Duhej nxituar se përndryshe nëna mund të largohej përsëri, siç pat bërë disa herë atë ditë.

Syri i zjarrtë i diellit po rrëzohej nga kupa e qiellit për në perëndim. Rrezet e tij përvëlonin dhe ushtari kullonte në djersë, ngjitur rafsh me tokën e zhuritur.

«Të dal hapur... Po detyra?...» mendonte,

Sikur të bënte si ndonja dyqind metra, arrinte në shesh, te lapidari, te godina e kryesisë, te banjat... ja edhe banjat që kish bërë organizata e rinisë, ja edhe lulishtja. Për këto i pati shkruar ajo



Lira... ja edhe çatia e vjetëruar e shtëpisë së verdhë, andej tutje... Plot gjurmë të reja e të vjetra i zinte syri. Aty, në atë shesh, Todi ishte ndarë me njerëzit, kur ishte nisur ushtar dhe kish hipur në kamionin e Lirës... Sa njerëz qenë mbledhur atë ditë te sheshi! Ndërsa tani, vetëm ata që bënë roje për qark godinës dhe kuzhinieri u vinte vërdallë kazanëve, që tymoseshin. Ata që bënë roje, qenë bashkëfshatarët e tij. Nuk ishte keq të pyeste. Por, sapo të hidhte këmbën për andej, ata me siguri do ta kapnin dhe vetëm në mbrëmje, pas detyrës, do përqafoheshin si shokë.

Nëpërmes shpendrave e thereckave e çoi shikimin te kuzhinieri, që e kish hequr gjimnastjorkën. Ai trazonte mirë e mirë gjellët dhe, me sa dukej, nga që nuk duronte diellin, futej prapa klubit, nën hije. Ky ishte ushtar i repartit të Todit dhe me siguri mund të rregullonte diçka me të. Mirëpo përsëri ndërroi mendje.

«Po sikur... më ngjan se e gjeta...» Mendoi dhe fët e fët hoqi gjimnastjorkën dhe doli nga vendi ku përgjonte. Ruajti kohën, kur kuzhinieri u fut në hije. Bëri kërcime të mëdha. U hodh një herë, dy, tri... Kuzhinieri ja behu që matanë.

Todi, këmba-doras, u sos te një qerre me qe të çmprehur. U tulat për një çast dhe mbajti vesh. Asnjë shenjë nuk u dha. Ai u qetësua. Dhe atë çast u shty më tutje, nën rrotat e qerres. Qetë e çmprehur sa s'e fshikën në fytyrë me bishtin e gjatë. Si zuri vend mirë, priti që kuzhinieri të mbaronte. Nga që s'kish ç'të bënte tjetër, hidhte shikimin për qark pa qëllim. Jo shumë larg, lexoi: fletërrufe.

Dhe më poshtë me gërma të mëdha:

«... Ne i themi Isait t'i lerë mënjanë pallavrat që kurdis poshtë e përpjetë, për çupat e fshatit. Lira, Naunka, Gjena s'janë siç i zë ngoje ai...»

Ushtari fërkoj sytë, ballin, qafën. «Ç'është kësh-tu?!...»

— Lira, Naunka, Gjena s'janë siç i zë ngoje ai...

## XI

Pa u fashitur ende ai purpur i zakonshëm i perëndimit, në qiell u ngrit një raketë, shenjë e gjelbër. Nuk kaloi shumë dhe në fshat hynë ushtarët me këngë rreshtore në gojë. Ata u shpërndanë aty në shesh e u përziën me vendasit, që mbanin veshur uniformë. Që të gjithë këmbenin mendime për detyrën që kishin plotësuar, pastaj zunë të bisedonin shtruar për punët e bujqësisë.

Aliu shkante te shokët dhe gjëja e parë që bënte ishte t'u kontrollonte pagurët. «Ujë» thërriste ngado që vërtitej.

— Ore, ç'u bë ai Todi?.. Paska qenë i lig, për besë!

Ca ushtarë kishin hequr këpucët dhe pecet i kishin nderur. Të tjerë rrinin shtrirë në kurriz e s'ngopeshin së shikuari hapësirën e paanë të qiellit ngjyrë çiviti, që sa vente errësohej. Era e freskët e detit u përthante djersët, i mbushte me kënaqësi. Fëmijët qëndronin më këmbë për qark ushtarëve dhe mendonin sikush për vete.

«Këta kanë zbritur nga qielli, ore!»



Komisari dhe komandanti qenë ulur në ca stola të gjatë, përpara klubit. Fshatarë të shumtë, të moshuar e të rinj, ishin mbledhur aty dhe bënë pyetje nga më të ndryshmet. Më pak nga të gjithë flisnin nëna e Todit dhe xha Uani. Ata të dy qenë pushtuar nga një farë gëzimi që të ndrydh.

— Ashtu, bir i nënës, ashtu... Dalshi faqebardhë ngahera, biri i nënës!

Këto përsëriste ajo duke i fërkuar dorën komisarit dhe mendonte:

«Oj, ç'gabova unë murga me atë letër që i nisa djalit!»

Ushtarët, si hëngrën darkë dhe u çlodhën pak, ja morën një kënge të shtruar partizane, që kujtonte vitet e luftës dhe të rënët. Të rinjtë e fshatit shkuan andej, se u pëlqente pa masë ajo këngë.

Lirimi e la këngën në mes. Shkoi te komisarit, iu afrua në vesh dhe i tha diçka me zë fare të ulët. Ata kthyen kokën andej nga po vinin dy njerëz.

— Ata janë — tha duke qeshur komisarit dhe shkonisti xhepin e vogël të xhakëtës.

Atë kohë, të gjithë sa ishin aty ngritën kokën për të parë dhe u çuan.

«Erdhën, erdhën!»

Nëna qëndronte në krah të komisarit dhe seç murmuriste me vete. E kishte pasur zakon, që të mos e shprehte dashurinë për djalin. Ajo e ruante atë përbrenda, të pastër e të zjarrtë, ashtu siç dinë nënat e dhimsura, që ngandonjëherë na duken të ashpra. Mirëpo kësaj radhe doli jashtë natyrës së saj dhe iu hodh në qafë të birit.

— Të keqen nëna!... — ja bëri dhe e pushtoi

me krahët e gjatë e të hollë, që i dridheshin. — Nga më humbe kështu? Me Lirën ishe? E, po ç'ka, bir i nënës... Gabova unë murgaa...

Dhe si t'ja kish blerë mendimet të birit, ajo mori nga vetja Lirën dhe e puthi edhe atë.

Të tjerët shikonin andej buzëgaz. Mëshqerra larushe vinte përçark sheshit. Lira e kishte hedhur vështrimin e saj të gjelbër mbi uniformat e ushtarëve. Ishte hera e parë që ajo i ngulte sytë në një vend dhe rrinte e heshtur se i vinte kiamet.

Xha Uani rëndonte mbi bastun me të dy duart. Ai tundte kokën sikur donte të thosh:

«Sa qenka hazdisur! Gjallë i ati u bë...»

— Pa qasu, mor bir, se mua s'më bëjnë këmbët — tha xha Uani dhe shtoi — Se qysh m'u prenë nga gëzimi... I ke qëlluar ato tabelat që merrnin për nishan apo jo? Sa për qiellin, s'di ç'të them unë...

Sheshi kishte gjallëri si kurrë ndonjëherë. Dritat aty përçark i merrnin errësirës nga një copë dhe e flaknin tutje. Së largu mbi fushë dukej shkëlqimi i kantierit të bonifikimit, buzë gjolit, të cilit po i vinte fundi. Ai shkëlqim i largët ngjante sikur buronte nga dheu.

Komisari iu afrua ushtarit dhe i vuri në dorë fletëlejen që e nxori nga xhepi i shkopsitur.

— Rri ca ditë — tha. — Ne do të nisemi.

Todi shikoi në sy nënën, xha Uanin, Lirën e të gjithë me radhë. Ata sikur i thoshin në një gojë: «Ti e di më mirë se ne... Ti tashti ke të bësh me armën, me tokën dhe qiellin...»

— Mirupafshim! — Thirri ushtari, ndërsa



maçina e fundit e la sheshin, duke derdhur nëpër fushë uturimë dhe dy fasha drite.

Ai ngutej të kthehej sa më parë atje në territorin ushtarak; atje, në dhomën kulturele, që t'ua thosh hapur shokëve çdo gjë që e kish mundur. Edhe mjeku duhej t'i dinte këto...

«Sa e rëndë që është, more shokë!...»

1969

---